

ANALIZA E ZBULIMEVE NGA HULUMTIMI PËR GJENDJEN ME TË DREJTAT E FËMIJËVE NË MAQEDONI

Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë Megjashi –
Republika e Maqedonisë

Titulli

Analiza e Zbulimeve nga Hulumtimi për
Gjendjen me të Drejtat e Fëmijëve në Maqedoni

Publikues

Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë Megjashi – Republika e Maqedonisë

Për publikuesin

m-r Dragi Zmijanac, kryetar dhe themelues

Autore

Dr. Sofija Georgievska
m-r Vaska Bojaxhi

Ekipi i projektit të PDAS Megjashi

Gordana Zmijanac, drejtuese e projektit – mentorë
Jordanka Çepernalkova-Trajkoska, koordinatore e projektit

Përkthim në gjuhën shqipe:

Eniena Aeti

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “Të marrim të drejtat në duart tona”, që zbatohet nga Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë Megjashi – Republika e Maqedonisë, në partneritet me Save the Children Kosovo, dhe financiarisht është mbështetur nga Qeveria e Suedisë. Përgjegjësia për përmbajtjen tërësisht e mbajnë autorët. Qeveria e Suedisë nuk është pajtjetër të pajtohet me qëndrimet dhe interpretimet e shprehura.

FALËNDERIM

Ambasada e Parë e Fëmijëve në Botë Megjashi – Republika e Maqedonisë shpreh falënderim të veçantë nxënësve nga Velesi, Vinica, Gostivari, Shkup dhe Dibra që kanë marrë pjesë në përgatitjen dhe zbatimin e pyetësorit, mësimeve të tyre të cilët janë kyçur në mënyrë aktive në procesin, si dhe studentët e Fakultetit Filozofik në Shkup që kanë qenë vullnetarë në procesin e mbledhjes së të dhënave.

I falënderojmë gjithë fëmijët që kanë plotësuar pyetësorin dhe kanë ndarë kohën për të shkëmbyer përvojat, mendimet dhe qëndrimet e tyre, si dhe prindërit/kujdestarët e tyre që kanë mbështetur pjesëmarrjen e fëmijëve.

Në fund, Ju falënderojmë edhe SurveyMonkey-it për mbështetjen në zbatimin e pyetësorit.

PËRMBAJTJA

QËLLIME TË HULUMTIMIT DHE QARJA METODOLOGJIKE	4
PARIMET ETIKE	5
PJESËMARRËS NË HULUMTIMIN	7
PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE.....	10
TEMA 1: NJOHJA ME TË DREJTAT E FËMIJËVE	15
1.1. Sa fëmijët i njohin të drejtat e tyre dhe nga informohen?.....	16
1.2. Sa respektohen të drejtat e fëmijëve?.....	19
1.3. Ku mund të drejtohen fëmijët nëse shkelen të drejtat e tyre?.....	21
1.4. A janë përfshirë fëmijët në aktivitete për mbrojtjen e të drejtave? A mendojnë dhe sa mendojnë që janë të fuqishëm fëmijët për të bërë ndryshime?	24
TEMA 2: MJEDISI SHKOLLOR	30
2.1. Si e perceptojnë fëmijët shkollën?	30
2.2. Çfarë ju pëlqen fëmijëve, dhe çfarë mendojnë se duhet të ndryshohet në shkollën e tyre? ...	31
2.3. Si ndjehen nxënësit dhe të punësuarit ndaj fëmijëve të grupeve të ndryshme?.....	35
2.4. A ka në shkollat kushte përkatëse për fëmijë me aftësi të kufizuara?	36
TEMA 3: KOHA E LIRË	38
3.1. Si e përdorin fëmijët kohën e tyre të lirë?	38
3.2. A kanë dhe sa kanë mundësi fëmijët për sportim?	42
TEMA 4: SHËNDETI DHE CILËSIA E JETËS	45
4.1. A mendojnë fëmijët që zhvillojnë jetë të shëndoshë?.....	45
4.2. Çfarë ushqimi konsumojnë fëmijët kur janë në shkollë?	45
4.3. Si ndjehen fëmijët dhe a bisedojnë me dikë për ndjenjat e tyre.....	46
4.4. Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	48
TEMA 5: MJEDISI JETËSOR	52
5.1. Me çfarë probleme ekologjike përballohen fëmijët?	52
5.2. A kanë marrë dhe sa kanë marrë pjesë fëmijët në aktivitete për mbrojtjen e mjedisit jetësor?	56
TEMA 6: SIGURIA DHE REHATIA	60
6.1. Sa ndjehen të sigurt fëmijët?	60
6.2. Përvoja e fëmijëve me dhunën.....	62
TEMA 7: DISKRIMINIMI.....	67
TEMA 8: INFORMACIONE PLOTËSUESE	73
ANEKS 1: Pëlqim nga prindi/kujdestari.....	75
ANEKS 2: Pyetësor mbi të drejtat e fëmijëve.....	79

QËLLIME TË HULUMTIMIT DHE QARJA METODOLOGJIKE

Hulumtimi për gjendjen me të drejtat e fëmijëve në Maqedoni ishte zbatuar për të siguruar të dhëna më të përfshirë për më tepër aspekte të jetës së fëmijëve në vend, problemet me të cilat fëmijët përballohen dhe gjërat të cilat ata konsiderojnë se duhet të përmirësohen. Zbulimet nga hulumtimi do të shërbejnë si bazë niseje në përgatitjen e Raportit Alternativ për Fëmijët mbi Gjendjen me të Drejtat e Fëmijëve në Maqedoni që do të parashtrohet para Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve pranë organizatës së Kombeve të Bashkuara në nëntor 2020, në kuadër të ciklit për njoftimin periodik për zbatimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (KDF).

Hulumtimi ishte konceptuar dhe zbatuar në përputhje me “qasjen e batuar në të drejtat e fëmijëve”, që nënkupton integrim të standardeve për KDF në çdo aspekt të procesit, përfshirë edhe përcaktimin e qëllimit, zgjedhjes së metodave për mbledhjen e të dhënave dhe korniza etike, si dhe përfshirje aktive të fëmijëve në procesin e hulumtimit.¹

Të dhënat ishin mbledhur në periudhën qershor-korrik 2020, me anë të pyetësorit anketues në gjuhën maqedonishte dhe shqipe. Pyetësi anketues ishte administruar online me anë të platformës SurveyMonkey.

Para fillimit të pyetësorit anketues ishin prezantuar informacione themelore në lidhje me hulumtimin të cilat ishin të nevojshme për sigurim të pëlqimit informativ për pjesëmarrje, si dhe udhëzime për plotësimin. Pyetësi përbëhej nga pjesa me të dhëna të përgjithshme dhe 68 pyetje, të ndara në tetë tërësi tematike:

- njohja me të drejtat e fëmijës
- mjedisi shkollor
- koha e lirë
- shëndeti dhe cilësia e jetës
- mjedisi jetësor
- siguria dhe rehatia
- diskriminimi
- informacione plotësuese

Pyetësi anketues ka përmbajtur edhe pyetje të hapura dhe të mbyllura në formate të ndryshme (me mundësi për zgjedhje të një prej përgjigjeve të ofruara, me mundësi për zgjedhje të më tepër prej përgjigjeve të ofruara, me përdorimin e shkallës së Likertit), si dhe pyetje të kombinuara (me mundësi për të shkruaj përgjigjen, përveç atyre të dhënë). Kjo ka mundësuar mbledhjen e të dhënave të natyrës cilësore dhe sasiore.

Pyetësi ka kaluar nëpër disa faza të dizajnit dhe përpunimit në të cilat përveç ekipit të hulumtimit, ishin përfshirë gjithsej tridhjetë nxënës nga 11 shkolla filllore dhe të mesme nga Velesi (SHMK “Koço Racin” dhe SHMK “Dimitrija Çupovski”), Vinicë (SHMK “Vanço Prke” dhe SHFK “Slavço Stojmëski”), Gostivar (SHMK “Gostivari” dhe SHEMK “Gostivari”), Dibër

¹ Lundy, L and McEvoy, L. (2012). Childhood, the United Nations Convention on the Rights of the Child, and Research: What Constitutes a ‘Rights-Based’ Approach?. Law and Childhood Studies. Oxford: Oxford University Press, f.75-91

(“SHMK “28 Nëntori” dhe SHFK “Said Najdeni”) dhe Shkup (“SUGS “Nikola Karev”, SUGS “Zef Lush Marku” dhe SHFK “Stiv Naumov”) të cilët kanë pranuar ftesën e Megjashit për pjesëmarrje në procesin. Këto nxënës dhe vetë shkollat ishin pjesë e aktiviteteve të Megjashi në kuadër të projektit “Të marrim të drejtat në duart tona” dhe Programit për Arsim të Qetë, me anë të cilën janë përfitur me njohuri themelore për të drejtat e fëmijëve. Me nxënësit ishin zhvilluar disa punëtori dhe takime online për të avancuar njohuritë e tyre dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre në fushën e të drejtave të fëmijëve, procesin e njoftimit para Komitetit për të Drejtat e Fëmijës dhe rëndësia dhe metodologjia e punës hulumtuese. Pjesëmarrje në punëtoritë dhe takimet kanë marrë edhe mësime dhe anëtarë tjerë të stafit shkollor, që kanë mbështetur nxënësit. Ky grup i nxënësve ishte përfshirë edhe në pilotimin e propozim-pyetësorit që ishte me rëndësi themelore për përmirësimin e strukturës dhe përmbajtjes². Versioni i fundit ishte krijuar pas pilotimit të propozimit dhe inkorporimit të ndryshimeve të propozuara nga ana e nxënësve. Me pjesëmarrjen e fëmijëve në këto faza fillestare të hulumtimit ishte siguruar që temat e përfshirë në pyetësorin janë me rëndësi për fëmijët, që informacionet janë prezantuar dhe pyetjet janë formuar në gjuhë të kuptueshme për fëmijët, si dhe që gjatësia dhe formati janë të drejtë. Përveç kësaj, nxënësit kanë dhënë edhe mendimin e tyre në lidhje me përmbajtjen e formularit për pëlqim nga prindërit/kujdestarit, pas së cilës ishin bërë edhe modifikime përkatëse.

Në fazën e mbledhjes së të dhënave kanë qenë vullnetarë prej dhjetëra studentë të Institutit për Punë Sociale dhe Politikë Sociale nga Fakulteti Filozofik pranë Universitetit “Shën Qirili dhe Metodi” Shkup, dhe kontribut të vet ka dhënë edhe grupi i nxënësve. Për studentët dhe nxënësit ishin hartuar protokolle të veçanta për veprim, të cilët mes tjerave kanë parashikuar edhe marrjen e detyrueshme të protokollit të së paku njërit prej prindërve/kujdestarëve para ndarjes së pyetësorit me vetë fëmijët – nxënësit në hulumtim.

Përpunimi statistikor i të dhënave sasiore ishte bërë me programin IMB SPSS (Statistical Package for Social Sciences), ndërsa për analizën e të dhënave sasiore ishte përdorur programi Provalis Research Text Analytics Software.

Në prezantimin e të dhënave në kuadër të këtij publikimi ishte kujdesur që mos të kalohet në analizën e tepërt të tyre, me çfarë do të jepet liri grupit të nxënësve në fazën e interpretimit të zbulimeve, arritjes së konkluzioneve dhe rekomandimeve³ të cilat do të prezantohen në Raportin Alternativ për Fëmijë për Gjendjen me të Drejtat e Fëmijëve.

Kjo analizë, bashkë me versionin e shkurtuar për fëmijë, si dhe Raporti Alternativ për Fëmijë do të ndahen me gjithë fëmijët që kanë marrë pjesë në hulumtimin si dhe me prindërit/kujdestarët e tyre. Do të ndahet edhe me aktorët e ndryshëm në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe me opinionin më të gjerë.

PARIMET ETIKE

Hulumtimi është zbatuar në përputhje me Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve të Ambasadës së Parë për Fëmijë në Botë Megjashi, Kodi Etik i Ambasadës së Parë për Fëmijë në Botë

² Gallagher, M. (2009). Data Collection and Analysis, bo E.K.M. Tisdall, J.M. Davis, and M. Gallagher (eds.), Researching with Children and Young People: Research Design, Methods and Analysis. London: SAGE Publications Ltd., f.65-128

³ Davis, J. M. (1998). Understanding the Meaning of Children: A Reflexive Process. Children and Society, 12 (5), f. 325-355

Megjashi, Procedurës së Save the Children për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Udhëzimin e Save the Children për procedura të pëlqimit për pyetësorë online. Përveç kësaj, ishin respektuar edhe standardet etike për hulumtim që përfshin fëmijë me anë të respektimit të parimeve më poshtë:

Vlerësim i rreziqeve dhe përfitimeve

Para fillimit të hulumtimit ishte kryer vlerësimi i rreziqeve dhe përfitimeve nga hulumtimi⁴. Nuk ishin identifikuar pasoja potenciale të dëmshme për pjesëmarrësit në hulumtim. Përveç kësaj, në linjë me praktikën e mira ndërkombëtare⁵, në pjesën fillestare dhe përfundimtare të pyetësorit ishin vendosur informacione për SOS telefonin për fëmijë dhe të rinj të Megjashit dhe fëmijët ishin informuar që mund të drejtohen këtu nëse ndjehen të shqetësuar, të brengosur ose nëse kanë nevojë që të bisedojnë me të rritur për ndonjë problem. Shpërndarja e rezultateve nga hulumtimi do të kontribuojë për rritjen e informimit të aktorëve relevant në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar në lidhje me të drejtat e fëmijëve, të cilat janë në pozitë të ndikojnë mbi legjislaturën vendosore, politikën dhe praktikën dhe me atë të kontribuojnë për avancimin e të drejtave të fëmijëve. Në këtë mënyrë, përfitimet e këtij hulumtimi janë kryesisht “të orientuar drejt të ardhmes, për fëmijët si grup social në vend të përfitimit të drejtpërdrejtë të fëmijëve që kanë marrë pjesë në hulumtimin”⁶. Megjithatë, të anketuarit kanë shprehur kënaqësinë për pjesëmarrje në hulumtim, mundësinë për të shprehur mendimin e tyre për një spektër të gjerë të temave dhe me atë në mënyrë potenciale të kontribuojnë për adresimin e problemeve të caktuara me të drejtat e fëmijëve.⁷ Pjesëmarrësve nuk ju ishte paguar kompensim për pjesëmarrje në hulumtimin.

Pëlqim i informuar

Të gjithë pjesëmarrësit, si dhe prindërit/kujdestarët e tyre ishin të informuar për hulumtimin, qëllimin, rolin e tyre në procesin, konfidencialitetin dhe aspektin anonim të të dhënave, karakteri vullnetar për pjesëmarrje në hulumtimin, si dhe mundësia për tërheqje nga procesi hulumtues. Pëlqimi i prindërit/kujdestarit për pjesëmarrje të fëmijës në hulumtim ishte marrë me anë të plotësimit të formularit online (Aneksi 1: Pëlqimi nga prindërit/kujdestari). Para se të mund të fillojnë me plotësimin e pyetësorit fëmijët gjithashtu duhet të konfirmojnë se i kuptojnë gjitha informacionet lidhur me hulumtimin, kanë marrë pëlqimin nga së paku njëri prej prindërve/kujdestarëve, si dhe që pajtohen që të marrin pjesë në hulumtimin (Aneksi 2: Pyetësor për të drejtat e fëmijëve). Fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve ju ishte treguar se ku mund të drejtohen nëse kanë nevojë për informacione plotësuese.

Konfidencialiteti dhe anonimiteti

Të gjithë pjesëmarrësit në hulumtim dhe prindërit/kujdestarët e tyre ishin informuar që do të mbrohet privatësia e tyre, që të dhënat e mbledhura në hulumtim do të publikohen vetëm në formë agregate dhe identiteti i fëmijëve dhe prindërve/kujdestarëve nuk do të zbulohet në asnjë mënyrë. Të dhënat e mbledhura ishin të ruajtura në mënyrë të sigurt në kompjuterin e

⁴ Alderson, P. and Morrow, V. (2012). Assessing Harms and Benefits, *The Ethics of Research with Children and Young People: A Practical Handbook*, 2nd ed., f.23-30. London: SAGE.

⁵ Alderson, P. (2004). Ethics, in Fraser, S., Lewis, V., Ding, S., Kellett, M. & Robinson, C. (eds.) *Doing Research with Children and Young People*. London: Sage. f.97-112

⁶ Graham, A., Powell, M., Taylor, N., Anderson, D. and Fitzgerald, R. (2013). Ethical Research Involving Children. Florence: UNICEF Office of Research – Innocenti, f. 33. <https://www.unicef-irc.org/publications/706-ethical-research-involving-children.html> [Qasur më 10.08.2020].

⁷ Shikoni Tema 8: Informacione plotësuese.

Ambasadës së Parë për Fëmijë Megjashi, dhe qasje në ato kanë pasur vetëm anëtarët e ekipit të hulumtimit. Pas përfundimit të hulumtimit, ishin fshirë nga platforma SurveyMonkey me anë të së cilës ishte zbatuar pyetësi.

PJESËMARRËS NË HULUMTIMIN

Hulumtimin e kanë filluar 1276 fëmijë, dhe kanë mbaruar 1077 fëmijë, prej të cilëve 38,94% ishin meshkuj dhe 60,26% femra (0,78% prej fëmijëve nuk kanë dhënë të dhëna të vlefshme për gjininë e tyre).

Në hulumtimin kanë marrë pjesë nxënës të shkollave fillore (47,60%) dhe të shkollave të mesme (62,69%). Moshë e fëmijëve ishte 12-17 vjeç, ndërsa mosha mesatare e gjithë mostrës ishte 15,04 vjeç.

Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në hulumtim (84.12%) janë me përkatëse etnike maqedonase, ndërsa 16% janë anëtarë të komuniteteve etnike pakicë (shqiptarë, rom, serb, turq, vllah, boshnjak dhe kroatë).

Përkatësia etnike	
Maqedonas/maqedonase	84.12%
Shqiptar/shqiptare	7.33%
Serb/serbe	1.94%
Turk/turke	3.34%
Rome/rome	0.74%
Vllah/vllahe	0.92%
Përkatësi tjetër etnike	1.57%

Në hulumtim ishin përfshirë fëmijë nga 78 qytete dhe prej gjitha rajoneve të vendit. Në lidhje me vendbanimin, 74,21% jetojnë në qytet, ndërsa 25,78% jetojnë në fshat.

Përveç të dhënave demografike, në kuadër të pjesës për të dhëna të përgjithshme, fëmijët kanë pasur mundësi të ndajnë diçka tjetër për veten. Ata kanë treguar për hobin e tyre, veçoritë personale, gjendjen emocionale dhe shëndetësore, familjen e tyre, si dhe për aspiratat për të ardhmen. Më poshtë janë dhënë një pjesë e përgjigjeve.

Flas 4 gjuhë. Kam trajnuar not dhe volejball. Di të këndoj, më thonë se jam e talentuar për të shkruar ese, këngë dhe tekste. Më pëlqen të gatuaj.

Dua të ndryshoj sistemin politik në vendin tonë.

Unë jam kërcimtar

Unë jam një fëmijë i operuar nga skolioza dhe gjithashtu kam Disleksi/diskalkuli

Më pëlqen të shoqërohem me miqtë e mi.

Fëmija i një prindi të vetëm.

Dua të jem pilot.

Më pëlqen të lexoj libra.

Jam inovative, komunikuese, emocionuese dhe e sigurtë, por nganjëherë të metat fitojnë.

Jam vullnetare e UNICEF-it.

E dua artin, muzikën, e kaloj kohën time të lirë me familjen dhe miqtë.

Ushtraj hendbollin.

Jam nxënëse e shkëlqyer dhe i dua shumë gjuhët.

Kam pasion mjekësinë, jam entuziast, ambicioz, më pëlqen: udhëtimi, të ndjek seriale, të lexoj libra ...

Jetoj në një familje të lumtur, e rrethuar nga 10 persona dhe me shumë dashuri nga secila prej tyre.

Jetoj me prindërit dhe dy motrat e mia.

Kam hobi dhe më pëlqen shumë të kërcëj.

Dua të them që më pëlqen të marr pjesë në fushata dhe debate për fëmijët, veçanërisht për të drejtat tona.

Unë jam i rrethuar nga shumë fëmijë të ndryshëm, veçanërisht që kur fillova shkollën e mesme, dhe ato ndryshime në të menduarit më kanë ndihmuar të kuptoj shumë gjëra për të tjerët, dhe për veten time, kështu që mund të them se tani jam një person shumë më i sigurtë dhe i hapur.

Kërcej balet.

Vullnetar në Kryqin e Kuq dhe më pëlqen argëtimi dhe aventura e mirë.

Më pëlqen të aktroj dhe të shkruaj poezi.

Kam lindur në Shtetet e Bashkuara.

Në çdo situatë i shikoj gjithmonë gjërat pozitive.

Më pëlqen të shkruaj, këndoj, hip hopi dhe të luftoj për të drejtat e njeriut.

Tani do të jem në klasën e 9-të dhe jam kampion kombëtar i notit.

Kur të rritem dua të jem mjek.

Dua të hulumtoj vende të reja.

Më pëlqen të vizatoj.

Adoleshent i lumtur, argëtues, ushtraj basketboll, shikoj filma.

Dua të bëj shumë hulumtime në fushën e pjesës historike të vendit tonë.

Jam shumë zemër.

Trajnoj futboll dhe kam një vëlla binjak.

Po, se jam temperamente.

Jam në korin e shkollës.

I dua kotelet, i unë dua edhe këlyshit, por vetëm derisa janë të vegjël.

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE

TEMA 1: NJOHJA ME TË DREJTAT E FËMIJËVE

- 56,4% prej fëmijëve konsiderojnë që janë të njohur me të drejtat e fëmijëve
- 62.8 % kanë dëgjuar për konventën për të drejtat e fëmijës, dhe vetëm 2.85% e kanë lexuar.
- Fëmijët më shpesh informohen për të drejtat e tyre në shkollë (92.33%), në internet (55.83) ose në shtëpitë e tyre (51.91).
- 95% e fëmijëve konsiderojnë që fëmijët dhe të rriturit duhet të edukohen më tepër për të drejtat e fëmijëve.
- Fëmijët konsiderojnë që të drejtat e tyre më së tepërmi respektohen në shtëpitë e tyre, ndërsa më pak në shkollat dhe vendbanimin e tyre. Andaj, 56.84% mendojnë që të drejtat e fëmijëve tërësisht respektohen në shtëpinë, 37.32% konsiderojnë që të drejtat e fëmijëve respektohen në shkollë, ndërsa 28.19% në vendbanimin.
- Fëmijët theksojnë shumë raste kur të drejtat e fëmijëve nuk respektohen, përfshirë edhe kur fëmijët janë lëndë e diskriminimit dhe dhunës, kur fëmijët janë të ndaluar të vijojnë shkollimin, kur mendimi i tyre nuk respektohet, kur ata jetojnë në varfëri, kur e kanë rrezikuar të drejtën e mjedisit të shëndoshë të jetës për shkak të ajrit të ndotur.
- Në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, pjesa më e madhe e fëmijëve 92.43% do të drejtohen familjes së tyre, 74.27% pedagogut, psikologut ose personit tjetër profesional në shkollë, 71.08% mësimdhënësit/profesorit. Më pak fëmijë do të drejtohen në Qendrën për Punë Sociale (34.31%), SOS-linjë (31.57%), Avokati i Popullit (20.80%) ose organizatë joqeveritare (20.80%).
- Pothuaj se 2/3 e fëmijëve kanë dëgjuar për Ambasadën e Fëmijëve Megjashi dhe Avokatin e Popullit.
- Pjesa më e madhe e fëmijëve (61.76%) konsiderojnë që fëmijët janë të fuqishëm për të ndryshuar *vetëm disa* prej gjërave që janë të rëndësishme. Fëmijët theksojnë që respektimi i pamjaftueshëm dhe vlerësimi i mendimit të tyre nga ana e të rriturve paraqet një prej pengesave kryesore për të cilën nuk mund të ndryshojnë gjërat që i kanë të rëndësishme, ndërsa një pjesë theksojnë mungesën e përvojës, informimit i dobët, mosha dhe ndihma e pamjaftueshme nga të rriturit, si dhe pengesat sistimore nga natyra ekonomike, politike dhe shoqërore dhe normat përkatëse që pengojnë pjesëmarrjen e fëmijëve.

TEMA 2: MJEDISI SHKOLLOR

- Pjesa më e madhe e fëmijëve ndjejnë që takojnë në shkollën e tyre (69.74%), konsiderojnë që janë të respektuar nga ana e nxënësve (66.35%), profesorët dhe personat tjerë që punojnë në shkollën (62.97%) dhe do të drejtohen mësimdhënësit/profesorit ose person tjetër të rritur nëse nuk ndjehen të sigurt (74,62%).

- Një pjesë e rëndësishme e fëmijëve (60,62%) konsiderojnë që nuk dedikohet vëmendje e mjaftueshme mirëmbajtjes së higjienës në shkollë, përfshirë edhe higjienës në tualetet, për shkak edhe disa nxënës shmangin që të përdorin (68,23%).
- Vetëm 1/3 e fëmijëve tërësisht pajtohen me pohimin që janë të përfshirë kur merren vendime në shkollën e tyre, ndërsa më tepër se gjysma tërësisht pajtohen me pohimin që mësimdhënësit/profesorët e tyre e respektojnë mendimin e tyre.
- Pjesa më e madhe e fëmijëve pajtohen me pohimin që kujdestari i klasës i dërgon nxënësit tek psikologu ose pedagogu vetëm nëse kanë bërë ndonjë problem (68.98% tërësisht pajtohen dhe 22.74% pjesërisht).
- Në mesin e arsyeve më të theksuara për të cilat nxënësit e duan shkollën e tyre kanë përmendur edhe ndjenjën e përkatësisë dhe sigurisë, mundësitë për të mësuar gjëra të reja, hapësira e rregulluar mirë dhe higjiëna, zgjedhja e madhe e aktiviteteve jashtë mësimore, stafi i shkollës dhe shoqërimi me shokët.
- Nëse do të kishin mundësinë, pjesa më e madhe e fëmijëve do të mundoheshin të rregullojnë relacionet me mësimdhënësit/profesorët me nxënësit, do të bënin më tepër për shëndetin mental të fëmijëve dhe do të siguronin që të gjithë fëmijët të jenë të lumtur, të dashuruar dhe të sigurt, do të avancojnë edhe shëndetin fizik të fëmijëve me anë të afirmimit më të gjerë të sportit dhe pajisjes më të mirë dhe më tepër orë të edukatës fizike dhe arsim shëndetësor, do të kenë më tepër kujdes për higjiënën në shkollë, do të përmirësonin cilësinë e mësimin dhe do të bënin orët më interesante, do të mundoheshin më tepër të komunikojnë me nxënësit dhe të përfshijnë në marrjen e vendimeve.
- Vetëm 28.67% e nxënësve kanë theksuar se në shkollat ka rampë për të ngjitur me karrocë, ndërsa 19,50% që ka ndihmës që ndihmon fëmijët me aftësi të kufizuar gjatë kohës së mësimin.

TEMA 3: KOHA E LIRË

- Gjysma e nxënësve (53%) konsiderojnë që çdoherë kanë mjaft kohë të lirë në të cilën çlodhen.
- 64.07% theksojnë që kohën e lirë e kanë të kufizuar për shkak të detyrave të shumta të shtëpisë dhe obligimeve të shkollës.
- Pothuaj se 80% e fëmijëve kanë kushte për pjesëmarrje në aktivitetet të cilat kënaqen në vendbanimin, por theksojnë shumë gjëra që mungojnë i sipërfaqe të gjelbër, vende për sport dhe çlodhje, aktivitete kulturore dhe edukative. Fëmijët që jetojnë në mjediset rurale dhe qytetet më të vogla posaçërisht theksojnë mungesën e kushteve, aktiviteteve dhe vendeve në të cilat ata do të kalonin kohën e tyre të lirë.
- Më shpesh, fëmijët kalojnë kohën e tyre duke u shoqëruar me shokët jashtë shtëpisë, duke dëgjuar muzikë ose në medie sociale. Shumë pak janë ata që vizitojnë ngjarje kulturore, kinema, orë private për muzikë dhe shëtitje të kafshës shtëpiake.
- Gjysma e fëmijëve theksojnë që në vendbanimin e tyre ka mjaft klube sportive dhe aktivitete sportive. Të anketuarit mendojnë që ka më tepër faktorë që ndalojnë fëmijët të marrin pjesë

në aktivitete sportive, mes të cilëve më të rëndësishme janë shpenzimet e mëdha dhe koha e kufizuar. Frika që nuk do të jenë të suksesshëm në sportin dhe mungesa e shoqërisë për vizitë të aktiviteteve sportive gjithashtu janë pengesa për disa prej fëmijëve.

TEMA 4: SHËNDETI DHE CILËSIA E JETËS

- Përqindja më e madhe e fëmijëve mendojnë se ushqehen shëndetshëm (72.47%), flenë mjaftueshëm (81.91%) dhe janë aktive në aktivitete fizike (70.36%).

- Kur janë në klasë, pjesa më e madhe e fëmijëve (63.33%) çdo ditë blejnë ushqim nga shitorja/furra/sandviçë lokale, por një pjesë konsumojnë ushqim të siguar nga shkolla ose të përgatitur në shtëpi. Për 1/5 e fëmijëve njëherë ose dy herë në javë ju ndodh që mos të hanë kur janë në shkollë.

- Për pjesën më të madhe të fëmijëve (51.88%) ushqim i përditshëm në shkollë është një lloj i brumit (gjevrek, byrek, kiflet, etj.). Një pjesë e caktuar e fëmijëve në baza ditore konsumojnë ushqim të shpejtë (39.27%), ushqim i lehtë (38.02%) ose diçka të ëmbël si çokolatë, biskotë, kollac e tjera (42.83%). Më tepër se gjysma e fëmijëve asnjëherë nuk hanë perime, ndërsa më tepër se 1/3 asnjëherë nuk janë pemë kur janë në shkollë.

- Pjesa më e madhe e të anketuarve shpesh ndjehet e dashuruar, me disponim dhe i sigurt në vete, sesa pa disponim, pikëlluar ose shqetësuar. Pothuaj se gjysma e fëmijëve ndjehen të dobishëm çdo ditë, ndërsa 1/10 janë nën stres çdo ditë.

- Gjysma e fëmijëve bisedojnë me dikë për ndjenjat e tyre, posaçërisht kur janë të pikëlluar ose të shqetësuar, dhe ato shpesh janë anëtarë të familjes më të afërt ose miq të ngushtë, dhe jo shpesh flasin me persona profesional.

- Më tepër se 1/3 e fëmijëve dëshirojnë të bisedojnë me dikë për ndjenjat e tyre, dhe pothuaj se 1/10 preferojnë të shkruajnë ndjenjat e tyre në ditar, rrëfim ose vjerdhë në vend që të flasin me dikë. Një përqindje e vogël e fëmijëve nuk kanë me kë të bisedojnë (3.83%).

- Fëmijët ndajnë një sërë shembujsh të rrethinës së tyre me bashkëmoshatarët e tyre që jetojnë në varfëri dhe nuk kanë kushte elementare për jetesë, ndërsa mungon kujdesi përkatës nga ana e institucioneve dhe që zakonisht për këtë grup të fëmijëve sigurohet ndihmë me anë të aksioneve humanitare.

- Fëmijët theksojnë që kanë dëgjuar ose personalisht njohin bashkëmoshatar që nuk kanë marrë ndihmë përkatëse ose me kohë mjekësore për probleme me shëndetin fizik dhe publik, si dhe këto raste janë më të shpeshtë nga fillimi me pandeminë COVID-19.

TEMA 5: MJEDISI JETËSOR

- Më tepër se gjysma e të anketuarve kanë sipërfaqe të sigurta ose të pastra publike në afërsi, ndërsa pothuaj se 1/3 mendojnë që sipërfaqet e gjelbër në afërsinë e tyre nuk janë të pastër dhe të sigurt.

- Për 2/3 e fëmijëve problemi me ajrin e ndotur, posaçërisht gjatë periudhës së dimrit është situatë ditore.
- Fëmijët theksojnë që ajri i ndotur në masë të madhe ndikon mbi shëndetin e tyre fizik dhe mental, e kufizon funksionimin e tyre të përditshëm dhe i detyron që pjesën më të madhe të kohës së tyre të kalojnë mbyllur në shtëpitë e tyre. Një pjesë e fëmijëve theksojnë që vetëm më janë të mësuar të jetojnë në ato kushte dhe që ajri i ndotur nuk ndikon në jetën e tyre të përditshme ose në disponimin e tyre.
- Përveç ajrit të ndotur, fëmijët theksojnë edhe disa probleme tjera ekologjike në vendbanimin e tyre, si sipërfaqe të papastër, ndotja e ujit dhe dheut, jeshile të pamjaftueshëm, fabrika në afërsi të vendbanimeve që lëshojnë materie të dëmshme, deponi të pakontrolluar, djegia e mbeturinave, miniera dhe mungesa e vetëdijes ekologjike në vend.
- Pjesa më e madhe e fëmijëve (62.80%) kanë marrë pjesë në ndonjë aktivitet për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

TEMA 6: SIGURIA DHE REHATIA

- Në shkallën prej 1 deri 5, fëmijët në kuadër të mestarë ndjehen të sigurt në shtëpi (3.16) dhe në shkollë (3.18). Fëmijët ndjehen më pak të sigurt në lagjen e tyre (2.85), si dhe në internet (2.88).
- Qentë e rrugës që lëvizin nëpër rrugët janë një prej arsyeve kryesore që i bën fëmijët të ndjehen të pasigurt në vendin e tyre të jetesës, përveç mungesës së ndriçimit në rrugë, prania e dhunës dhe numri i tepërt i veturave.
- 10% e fëmijëve theksojnë që asnjëherë nuk kanë qenë viktimë e dhunës, ndërsa 21.85% njohin dikë që ka qenë viktimë e dhunës.
- 13% e fëmijëve theksojnë që janë gjetur në situatë të lëndojnë dikë dhe ajo shpesh ka qenë në vetëmbrojtje ose në mbrojtje të shokut/shoqes, si dhe kur kanë qenë nervoz ose të inatosur dhe nuk kanë ditur të kontrollojnë këto ndjenja, dhe ju ka ndodhur që pa dashje të lëndojnë dikë në mënyrë verbale.
- Pothuaj se 1/4 e fëmijëve theksojnë që njohin bashkëmoshatar që të dhënat, fotografi ose video janë vendosur në internet pa pëlqimin e tij/saj, ndërsa në *% ajo personalisht ju ka ndodhur.
- Nëse dikush i keqtrajton në internet, ose i keqpërdor të dhënat personale të tyre, pjesa më e madhe do të drejtohen familjes (76.75%) dhe në polici (59.72%), ndërsa 28.42% do të drejtohenin në Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

TEMA 7: DISKRIMINIMI

- 42.24% e fëmijëve janë ndier të diskriminuar në një situatë të caktuar dhe shpesh si arsye përmendet mosha, gjinia, si dhe gjendja financiare e familjes së tyre. Fëmijët gjithashtu

theksojnë që kanë qenë të diskriminuar edhe për shkak të dukjes së tyre, peshës trupore dhe ngjyrës së lëkurës, vendit të banimit, stilit të veshjes ose muzikën që dëgjojnë.

- 34.26% e fëmijëve kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit. Fëmijët sqarojnë që në disa raste nuk kanë reaguar për shkak të frikës, kanë qenë të vegjël dhe kanë menduar se nuk janë në gjendje të ndihmojnë. Në raste tjera fëmijët janë kundërshtuar personit që ka diskriminuar, dhe në numrin më të vogël ka ardhur në përlëshje fizike. Fëmijët gjithashtu ndajnë që janë drejtuar për ndihmë mësimdhënësve/profesorëve ose personave profesional në shkollë dhe kanë biseduar, i kanë qetësuar dhe i kanë inkurajuar fëmijët që kanë qenë të përqeshur ose diskriminuar.

- 6% janë përgjigjur që vetë ata kanë diskriminuar dikë kur kanë qenë të vegjël por nuk kanë qenë të vetëdijshëm se mund të lëndojnë me ato fjalë, por edhe për ndikim të fëmijëve tjerë me të cilët janë shoqëruar.

TEMA 8: INFORMACIONE PLOTËSUESE

Në pjesën e fundit, fëmijët kanë pasur mundësi që të ndajnë diçka që ata konsiderojnë se është e rëndësishme, por nuk është përfshirë në pyetësonin. Një pjesë e fëmijëve kanë theksuar që ka probleme me cilësinë e arsimit, diskriminimi aktual i grupeve të caktuar, si dhe nevoja për informim të fëmijëve për të drejtat e tyre. Disa prej komenteve përmbajnë ide për pyetje të cilat janë parashtruar, shprehje të kënaqësisë për pjesëmarrje në pyetësonin dhe interes që të mësojnë më tepër për atë nëse dhe si ky hulumtim do të kontribuojë për përmirësimin e jetës së fëmijëve.


TEMA 1:
NJOHJA ME TË
DREJTAT E FËMIJËVE

TEMA 1: NJOHJA ME TË DREJTAT E FËMIJËVE

Pjesa e parë e pyetësorit ishte dedikuar njohjes së fëmijëve me të drejtat e fëmijëve dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës, perceptimet e tyre për respektimin e të drejtave të fëmijës, institucionet/individët tek të cilët ata drejtohen/do të drejtoheshin në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, si dhe përfshirja e tyre në aktivitete për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

1.1. Sa fëmijët i njohin të drejtat e tyre dhe nga informohen?

Më tepër se gjysma e fëmijëve (56.4%) konsiderojnë se janë të njohur me të drejtat e fëmijës, ndërsa 37.84% se janë vetëm pjesërisht të njohur (shikoni figurën 1). Një pjesë e vogël e fëmijës (5.55%) konsiderojnë që aspak nuk janë të njohur me të drejtat e fëmijës.




Pyetja “Theksoni disa të drejta të fëmijës të cilat të kujtohen”, 520 (48.28%) fëmijët e kanë lënë të pa përgjigjur. Të drejtat më shpesh të përmendura nga ana e fëmijëve të cilët janë përgjigjur kësaj pyetje përfshijnë: të drejtën e lirisë, kohën e lirë dhe lojë, mbrojtja shëndetësore, barazi, jetë dhe siguri fizike, arsim dhe mbrojtja nga dhuna. Në përgjigjet e këtyre pyetjeve mund të vërehen dallime të mëdha mes vajzave dhe djemve (shikoni tabelën 2). Prej të drejtave më pak të përmendura, si tek djemtë ashtu edhe tek vajzat, përfshihen: pjesëmarrje në aktivitete kulturore dhe artistike, pjesëmarrje në marrjen e vendimeve dhe liria e konfesionit. Megjithatë, pothuaj se 80% e të anketuarve kanë njohur të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje në vendime dhe konsiderojnë që kur politikanët dhe gjykatat vendosin për çështje lidhur me fëmijët ata duhet të pyesin edhe ata se çfarë mendojnë (shikoni figurën 3).

Tabela 2: Theksoni disa të drejta të fëmijës të cilat të kujtohen.

5 të drejta më shpesh të përmendura nga ana e djemve	5 të drejta më shpesh të përmendura nga ana e vajzave
1. e drejta e lirisë (34.2%)	1. e drejta e kohës së lirë dhe lojës (28.54%)
2. mbrojtja shëndetësore (21.5%)	2. e drejta e barazisë (25.43%)
3. jetë dhe siguria fizike (19.27%)	3. e drejta e arsimit (22.34%)
4. jeta familjare (17.24%)	4. mbrojtja shëndetësore (18.26%)
5. mbrojtja nga dhuna fizike (12.21%)	5. jetë dhe siguria fizike (15.65%)

Figura 3: Kur politikanët dhe gjykatat vendosin për çështje lidhur me fëmijët, ata duhet të pyesin edhe fëmijët se çfarë mendojnë.



Nga përgjigjet e pyetjeve cila e drejtë sipas tyre është më e rëndësishme, shohim që dominojnë e drejta e jetës, arsimit dhe lirisë. Por, edhe në përgjigjet e këtyre pyetjeve mund të vërehen dallime të ndryshme në përgjigjet e vajzave dhe djemve (shikoni tabelat 4.1 dhe 4.2).

Tabela 4.1: Gjithë të drejtat janë njëlloj të rëndësishme, por për ty cila e drejtë është më e rëndësishme dhe pse?

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"E drejta e shprehjes së lirë dhe e jetës së lirë. Kjo e drejtë është më e rëndësishmja për mua sepse çdo mendim duhet të respektohet pa marr parasysh nëse është e vërtetë apo jo, të gjithë kemi disa minuta për të dëgjuar bashkëbiseduesin. Gjithashtu, çdo fëmijë ka të drejtën e një jete të lirë, d.m.th. asnjë fëmijë nuk duhet të ngacmohet dhe të detyrohet të bëjë gjëra që janë vetëm për të mirën e të tjerëve.

" E drejta e shprehjes, përkatësisht e drejta e votës është jashtëzakonisht e rëndësishme për mua si i ri sepse unë dua të që zëri im të dëgjohet dhe të këshillohen me mua për çështje më të rëndësishme. "

"E drejta për arsim është më e rëndësishmja. "Heqja e kësaj të drejte kontribuon në shkatërrimin dhe kufizimin e zhvillimit të fëmijës ."

"Sinqerisht, nuk mund të zgjidhja vetëm një, kështu që unë do të zgjedh dy: 1. E drejta për dashuri dhe kujdes. Sepse, shumë nga fëmijët dinë të shprehen më lirshëm në mediat sociale, dhe ka kaq shumë postime dhe komente në të cilat fëmijët thonë se nuk marrin (mjaf) dashuri nga prindërit e tyre, për arsye të ndryshme, dhe unë mendoj se kjo është alarmante dhe se ata duhet të ndihmohen. Disa nga arsyet më të njohura pse disa dëbohen edhe nga shtëpitë e tyre janë për shkak të gjinisë transgjimore , seksualitetit, fesë, dhe kjo më çon në të drejtën e dytë: 2. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë ai/ajo që është. (nga shumë aspekte të ndryshme). Vetëm se mund të jetë pjesë e komunitetit LGBT, ose pikëpamjet e tij/saj për fenë e prindërve të tij, nuk përputhet me bindjet e tyre, nuk do të thotë që ai/ajo duhet të lihet anësh, mos pranohet ashtu siç është, të dhunohet, abuzohet, keqtrajtohet me fjalë të ndyra, dhe të etiketohet si një "krijesë anormale". "




" E drejta për barazi, një jetë më të mirë dhe funksionim më të mirë, nuk duhet të ketë diskriminim, racizëm, ndarje etnike, të gjithë ne jemi të barabartë, dhe kjo, për fat të keq, shumë pak është kuptuar. "

Tabela 4.1: Gjithë të drejtat janë njëlloj të rëndësishme, por për ty cila e drejtë është më e rëndësishme dhe pse?


Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

të drejta më shpesh të përmendur nga ana e djemve	të drejta më shpesh të përmendur nga ana e vajzave
1. e drejta e lirisë (32.1%)	1. e drejta e jetës (27.2%)
2. e drejta e zgjedhjes (23.2%)	2. e drejta e mbrojtjes shëndetësore (22.34%)
3. e drejta e jetës (23.01%)	3. e drejta e lirisë (21.15%)
4. e drejta e lojës (21.23%)	4. e drejta e zgjedhjes (19.24%)
5. e drejta e arsimit (16.01%)	5. e drejta e arsimit (16.54%)

Fëmijët më shpesh informohen për të drejtat e tyre në shkollë, nga interneti ose në shtëpitë e tyre (shikoni figurën 5). Megjithatë, një pjesë e vogël e të anketuarve konsiderojnë që fëmijët dhe të rriturit janë mjaft të informuar për të drejtat e fëmijëve, dhe madje 95% konsiderojnë që ka nevojë për edukim më të gjerë për fëmijët dhe të rriturit (shikoni figurat 6 dhe 7).



Pjesa më e madhe e fëmijëve (62.8%) kanë dëgjuar për Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, por vetëm një pjesë e vogël (2.85%) e kanë lexuar. 1/3 e fëmijëve nuk kanë dëgjuar aspak për Konventën e të Drejtave të Fëmijëve.



1.2. Sa respektohen të drejtat e fëmijëve?

Fëmijët mendojnë që të drejtat e tyre më tepër respektohen në shtëpitë e tyre, ndërsa më pak në shkollat dhe vendbanimin e tyre (shikoni tabelën 9). Fëmijët theksojnë shumë raste kur të drejtat e fëmijëve nuk janë respektuar, përfshirë edhe kur fëmijët janë lëndë e diskriminimit (në bazë të moshës, gjinisë, përkatësisë fetare), dhunë (dhuna mes bashkëmoshatarëve, dhuna në familje, trafikimi me fëmijë, praktika të dëmshme tradicionale, keqpërdorimi i punës së fëmijëve), kur fëmijët janë të penguar të vijnë në shkollë, kur mendimi i tyre nuk respektohet, kur ata jetojnë në varfëri, kur e kanë të rrezikuar të drejtën e mjedisit të shëndoshë jetësor për shkak të ajrit të ndotur (shikoni tabelën 10).

Tabela 9: A mendon që njerëzit rreth teje i respektojnë të drejtat e fëmijëve?

	Po, tërësisht i respektojnë të gjitha të drejtat	Pjesërisht i respektojnë (disa të drejta po dhe disa jo)	Aspak nuk i respektojnë
Në shtëpi	56.84%	41.51%	1.64%
Në shkollë	37.32%	59.67%	3.01%
Në vendbanimin tënd	28.19%	67.43%	4.38%

Tabela 10: A ke njohuri për raste kur nuk respektohen të drejtat e fëmijëve?

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Dhuna në familje".

"Abuzimi i fëmijëve në mjedisin e të jetuarit ose në shkollë."

"Kur një fëmijë është i ekspozuar ndaj bullingut në shkollë nga shokët e klasës e tij, kurse psikologu ose ndonjë tjetër punonjës nuk ndërmer masa, prindërit e fëmijës ose nuk i prek ajo situatë, ose për shkak të arsyeve të caktuara nuk mund të bëjnë asgjë për të ndaluar situatën."

"Kur fëmijët abuzohen."

"Fëmijë i goditur nga një mësues".

"Kur detyrohen të martohen herët."

"Trafikimi i fëmijëve".

"Tallje e përditshme në mediat sociale, fyerje verbale dhe lëndime fizike."

"Kur do përlaheni me mikun tuaj dhe prindërit e tij vijë dhe ju bërtasin".

"Disa prindër, kryesisht në lagjet rome, nuk i edukojnë fëmijët e tyre."

"Kur fëmijët që duhet të shkojnë në shkollë janë të privuar nga kjo mundësi."

"Më shpesh është pranimi i fëmijëve të feve të tjera, ne shpesh hasim raste të tilla në shkollë."

"Kur një fëmijë privohet nga e drejta për të ndjekur kurse arsimore për shkak të përkatësisë etnike."

"Për shembull, në një situatë kur fëmija "urdhërohet" që të heshtë sepse mendimi i tij konsiderohet si mendim i një fëmije."

"Po, për shembull disa fëmijë nuk kanë të drejtë për arsim, ata nuk kanë të drejtë për sigurimit shëndetësor, asistencë sociale, ata thjesht nuk kanë të drejtën e jetës, por në disa raste prindërit nuk janë fajtorë sepse nuk mund t'u sigurojnë atyre të drejtat themelore, këtu i shoh fajtorë institucionet shtetërore sepse nuk kujdesen për ata fëmijë".

"Diskriminimi gjinor."

"Po, kur fëmijëve me aftësi të kufizuara ju shkurtohet jeta sepse qenkan turp për familjen."

"Kur nxënësit përbuzin shokët/shoqet e tyre të klasës për shkak të dallimeve racore ose fetare ose përdorin gjuhë abuzive."

"Ka raste kur fëmijët përbuzen për shkak të stilit të tyre të veshjes, ngjyrës së lëkurës, trupit ... Nëse një fëmijë nuk ka një trup të bukur dhe të dobët, ai vishet ashtu siç i pëlqen, nuk ka ngjyrën e lëkurës si shumica në atë mjedis dhe automatikisht "nuk përket atje" dhe fyhet me fjalë abuzive nga fëmijët që "i përkasin atje".

"Kur fëmijët refuzohen në disa raste për shkak të kombësisë ose fesë së tyre, kur për të njëjtën arsye edhe në institucionet shtetërore refuzojnë t'u ofrojnë ndihmë."

"Fëmijët që lypin ose janë të detyruar të punojnë nga të rriturit."

"Njoh raste aty ku jetoj, ku fëmija nuk lejohet të shkojë në shkollë dhe është i detyruar të punojë."

"Ka shumë të drejta të fëmijëve që nuk respektohen jo nga shteti por nga fëmijët dhe të rriturit. Disa prej tyre janë: dëbimi dhe mos riatdhesimi i paligjshëm, mbrojtja nga abuzimi, mbrojtja nga droga, puna e fëmijëve, mbrojtja nga shfrytëzimi seksual ... Të gjitha këto të drejta janë shkelur, një shembull i rëndësishëm i shkeljes së të drejtave të fëmijëve është e drejta e mbrojtjes nga droga. Shumë prej të miturve ende nuk e kanë zhvilluar sa duhet vetëdijen e tyre dhe sigurisht nuk janë të pjekur që të gjykojnë mirë, kështu që në një mënyrë të vetëdijshme/të pavetëdijshme ata blejnë, shesin drogë, nuk i tregojnë familjes së tyre ose disa profesionistëve të tjerë, dhe kështu shkatërrojnë jetën e tyre".

"Kur fëmija nuk është në gjendje vet të shprehë se çfarë është e mirë dhe e rëndësishme për atë, kështu që prindi është përgjegjës për të, por ai nuk e pyet fëmijën e tij, ai vendos vetë".

"Një rast i tillë është kur një prind vendos për drejtimin e edukimit të fëmijës së tij ose të saj edhe pse është në kundërshtim me dëshirat e tija/saja."

"Shumë herë ka ndodhur që mendimi ynë mos të dëgjohet plotësisht në shkollë. Këto ngjarje zakonisht përcillen nga fraza, "Ende keni shumë për të kaluar". Ne se jemi fëmijë nuk do të thotë që nuk kemi qëndrimin tonë, të gjithë ndërtojnë karakterin e tyre dhe kanë mendimin e vet. "Të gjithë mund të mos pajtohen me pikëpamjet tona, por unë mendoj se ato duhet të dëgjohen."

"Ka shumë raste të tilla". "Sidomos në shkolla nëse mësuesit nuk u besojnë fëmijëve kur duhet të bëjnë diçka personale, dhe ata e pengojnë atë duke menduar vetëm për klasën e tyre."

"Për shembull në shkolla, fëmijët kurrë nuk dëgjojnë nëse duan të ankohen për mënyrën e vlerësimit të një mësuesi."

"Një shembull është kur prindërit mbyllin fëmijën në shtëpi dhe nuk e lënë ta rri me miqtë e tij."

"Kur fëmijët luajnë në rrugë, të rriturit i qortojnë që mos të bërtasin dhe i përzënë prej rrugës. "Ata po privohen nga e drejta e tyre për të luajtur."

"E drejta më e shkelur e fëmijëve në vendbanimin tim është e drejta për të marrë frymë ajër të pastër."

"Fëmijët përdoren për politikë".

"Ka profesorë që zgjedhin të preferuarit e tyre dhe atyre ju japin nota më të mira nga të tjerët".

1.3. Ku mund të drejtohen fëmijët nëse shkelen të drejtat e tyre?

Pjesa më e madhe e fëmijëve, si vend në të cilën mund të denoncojnë mos respektimin e të drejtave të fëmijëve i theksojnë policinë, organizatat joqeveritare, profesorët, prindërit (shikoni tabelën 11).

Tabela 11: Çfarë mendon, ku mund të drejtohen fëmijët nëse shkelen të drejtat e tyre? (Specifiko)
Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Në një institucion publik për fëmijë që mbron të drejtat tona."

"Ata mund t'i drejtohen shkollës, UNICEF-it, MEGJASHI-it në raste ekstreme dhe në polici."


"Para së gjithash, nëse prindërit e tyre ua shkelin të drejtat në shtëpi, ata mund t'i drejtohen pedagogut ose profesorit në shkollën ku mësojnë."

"Përveç shtëpisë, nuk e di se ku mund të drejtohet, duhet të ketë një qendër për mbrojtje të drejtave të fëmijëve në Maqedoninë tonë".

"Unë mendoj se shumë fëmijë, të drejtat e të cilëve janë shkelur, ose nuk janë të vetëdijshëm sa duhet për situatën e tyre, ose kanë frikë t'i drejtohen dikujt, dhe unë nuk mendoj se ne jemi arsimit sa duhet në këtë aspekt."

Në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, pjesa më e madhe e fëmijëve (92.43%) do të drejtohen familjes së tyre, 74.27% pedagogut, psikologut ose person tjetër profesional në shkollë, 71.08% mësimdhënësit/profesorit. Më pak fëmijë do të drejtohen në Qendrat për Punë Sociale (34.31%), SOS linjë (31.57%), Avokati i Popullit (20.80%) ose në organizatë joqeveritare (20.80%).

Figura 12: Nëse të është shkëlur ndonjë e drejtë, a do të drejtoheshit tek:



12,71% e fëmijëve janë drejtuar për ndihmë kur kanë pasur nevojë për të drejtat e tyre tek prindërit, mësimdhënësi dhe kuadri profesional në shkollën, shokët (shikoni figurën 13), por vetëm 42% mendojnë që personi tek i cili do të drejtoheshin për ndihmë (shikoni figurën 14). Pjesa më e madhe e fëmijëve (69.29%) konsiderojnë që deri më tani nuk ju është shkëlur asnjë e drejtë (shikoni figurën 13).

Figura 13. A ke kërkuar ndonjëherë ndihmë kur është është shkëlur ndonjë e drejtë?





Figura 14: Nëse përgjigja është "po", sa të ka ndihmuar personi që jeni drejtuar?



Pothuaj se 2/3 e fëmijëve të përfshirë në këtë hulumtim kanë dëgjuar për Ambasadën e Fëmijëve Megjashi (shikoni figurën 15). Në masë të madhe fëmijët e njohin rolin e Ambasadës për Fëmijë Megjashi, si organizatë që përfaqëson të drejtat e fëmijëve dhe synon mbrojtjen e tyre dhe avancimin (shikoni tabelën 16).




Tabela 16. Cili mendon se cili është roli i Ambasadës së Parë të Fëmijëve në Botë Megjashi?
Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Të mbron dhe promovon të drejtat e fëmijëve."


"Ambasada Megjashi është e angazhuar të respektojë personalitetin e fëmijëve, të drejtat e tyre, interesat dhe mënyrën e pasurimit të njohurive në jetën e tyre."

"Për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve, për të bashkëpunuar me fëmijët dhe për të vlerësuar mendimin e tyre për gjëra dhe tema të caktuara."

"Zbatimi i të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtja e tyre."

"Përfaqësojnë të drejtat e fëmijëve."

"Për të mbrojtur fëmijët nga parregullsitë."



Pothuaj se i njëjtë është përqindja e fëmijëve që kanë dëgjuar për Avokatin e Popullit, dhe rolin e kanë identifikuar si kryesore nëse në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe kujdesi që fëmijët janë të mbrojtur mirë, dhe pala që ka shkelur të drejtat, të sanksionohet në mënyrë përkatëse.

Tabela 18. Cili mendon se cili është roli i Avokatit të Popullit?
Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Të mbron të drejtat e fëmijëve."

"Roli i tij është të mbrojtë të drejtat e fëmijëve në mesin e njerëzve, dhe ai punon në mënyrë të pavarur nga pushteti ekzekutiv."

"Nëse të drejtat e fëmijës janë shkelur, Avokati i Popullit duhet të bëjë çmos për ta provuar atë dhe të vendosë sanksione të përshtatshme."

"Të punon që të gjitha të drejtat e fëmijëve të respektohen dhe nëse cenohet një e drejtë të ndëshkon shkelësin."

"Për të përfaqësuar fëmijën para gjykatave."

1.4. A janë përfshirë fëmijët në aktivitete për mbrojtjen e të drejtave? A mendojnë dhe sa mendojnë që janë të fuqishëm fëmijët për të bërë ndryshime?

Vetëm 10% e fëmijëve kanë theksuar që janë përfshirë në aktivitete që mund të ndihmojnë fëmijët të drejtat e të cilëve nuk respektohen (shikoni figurën 19.1). Fëmijët shpesh i theksojnë aktivitetet e organizuar nga ana e Ambasadës për Fëmijë Megjashi dhe Kryqi i Kuq, aksione humanitare, aktivitete të ndryshme shkollore, përfshirë edhe me anë të punës së avokatëve të popullit për fëmijë. Një pjesë e fëmijëve marrin aktivitete me iniciativë personale, nëse supozohet që ka nevojë për atë (shikoni tabelën 19.2).



Tabela 19.2: A je i/e përfshirë në aktivitete me të cilat mund t'ju ndihmosh fëmijëve të drejtat e të cilëve nuk respektohen? Nëse po, cilat janë ato aktivitete? Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Nëpërmjet shkollës, në bashkëpunim me MEGJASHI, unë u përfshiva në një teatër forumesh nëpërmjet të cilit ne përhapëm mesazhin e jodhunës dhe gjithashtu si reporter i ri, unë punoj në krijimin e blogjeve për të njoftuar të rinjtë me të drejtat e tyre."

"Jam vullnetare në Kryqin e Kuq (Dega Karposh), ku ndihmohen fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët nga familjet e rrezikuara shoqërore."

"Marr pjesë aktive në aktivitetet që zhvillohen në shkollë."

"Jam e përfshirë në ekipin e Ombudsmanit të fëmijëve në shkollën sonë dhe organizojmë aktivitete të ndryshme dhe ngjarje bamirëse për fëmijë."

"Aktivitetet shkollore si 'Unë kam zë' ku ne flasim dhe bëjmë projekte për të drejtat e fëmijëve."

"Për shembull, unë kam marrë pjesë në shumë bamirësi në të cilat shumë njerëz kanë dhuruar dhe ne kemi ndihmuar familjet në nevojë."

"Shkojmë në jetimore çdo javë dhe i ndihmojmë fëmijët të zotërojnë aktivitete të caktuara që nuk kanë qenë në gjendje t'i bëjnë më parë."

"Emision dokumentar për mënyrën sesi adoleshentët jetojnë në shoqërinë tonë, dhe me cilat vështirësi përballen."

"Ndihmoj miqtë e mi".


"Unë nuk jam përfshirë në ndonjë organizatë, por vetë kur do t'i shoh ata ju ndihmoj, u them atyre se nuk ka turp të kontaktojnë prindin ose mësuesin, dhe gjithashtu fëmijëve të cilët nënçmojnë ose keqtrajtojnë fëmijët e tjerë ndalem dhe ju them që nuk duhet të veprojnë ashtu, nuk është mirë, nuk është korrekt apo sjellshëm dhe që dikush mund t'i raportojë për ato veprime."

"Jam presidenti i klasës dhe përpiqem të ndihmoj këdo që mundem."

"Ndjek shkollën e aktrimit, ku të gjitha shfaqjet që bëjmë janë me qëllim që fëmijët të gjejnë veten dhe të vetëdijesohen se cilat janë të drejtat e tyre".

Pjesa më e madhe e të anketuarve (61.76%) konsiderojnë që fëmijët janë të fuqishëm për të bërë ndryshime vetëm të gjërave që i kanë të rëndësishme (shikoni figurën 20.1). Fëmijët

Figura 20.1: A janë fëmijët e fuqishëm, sipas teje, për të ndryshuar gjërat që i kanë të rëndësishme?



theksojnë se respektimi dhe vlerësimi i pamjaftueshëm i mendimit të tyre nga të rriturit është një nga pengesat kryesore për shkak të së cilës ata nuk mund të ndryshojnë gjërat që kanë rëndësi për ata, ndërsa disa përmendin mungesën e përvojës, informacionin e ulët, moshën dhe ndihmën e pamjaftueshme nga të rriturit. Disa nga të anketuarit besojnë se ka pengesa sistematike të natyrës ekonomike dhe politike, si dhe norma shoqërore që kufizojnë pjesëmarrjen e fëmijëve. Nga ana tjetër, fëmijët shpjegojnë se janë të fuqishëm në ndryshimin e gjërave që janë të rëndësishme për ta, sepse ata kanë të drejtë ta bëjnë këtë, si dhe sepse kanë njohuri, kapacitete dhe potencial të mjaftueshëm. Fëmijët mendojnë se ata janë një brez i ri me një vetëdije më të lartë për problemet sociale, e cila ka më shumë mjete / platforma për të bërë ndryshime. Ata njohin nevojën për shoqatë dhe njohin rolin e organizatave dhe profesionistëve të ndryshëm që i ndihmojnë fëmijët të bëjnë ndryshimet për të cilat aspirojnë.

Tabela 20 . . A mendon se fëmijët kanë fuqinë që t'i ndryshojnë sendet që i vlerësojnë si të rëndësishme? Pse mendon kështu? (Shpjego)

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

• **Shpjegimet mbi atë se çfarë i ndalon fëmijët që të bëjnë ndryshime:**

"Sepse ne nuk jemi aq të rritur sa të ndryshojmë disa gjëra që nuk varen nga ne fëmijët."

"Sepse ne jemi thjesht fëmijë."

"Në disa gjëra, siç është sjellja e mësuesve dhe ngjashëm, fëmijët mund të bëjnë ndryshime duke folur hapazi për problemin. Por në shumë aspekte fëmijët janë të pafuqishëm, ndonjëherë për shkak të njohurive dhe përvojës së pamjaftueshme."

"Për shkak se ata janë fëmijë dhe nuk kanë përvojë dhe njohuri të mjaftueshme për disa gjëra, kanë vetëm mendime por nuk dinë nëse janë të mira."

"Disa gjëra nuk e dimë se si mund të ndryshohen."

"Sepse shumica e fëmijëve nuk janë të informuar sa duhet."

"Sepse ka fëmijë që kanë frikë, por nuk mund të ankohen."

"Të rriturit gjithmonë kanë pasur, dhe do të kenë, kontroll dhe reputacion shumë më të madh në botë. Çdo organ ose institucion drejtohet nga një i rritur, jo nga një fëmijë. Edhe pse fëmijët mund të ndikojnë në disa vendime më pak kritike, ato nuk mund të ndikojnë plotësisht në ligje dhe qeveri."

"Unë besoj se fëmijët janë mjaft të fuqishëm për të ndryshuar shumë gjëra, veçanërisht nëse bashkohen në numër të madh, por jo të gjitha sepse ne jetojmë në një shoqëri ose një botë, në përgjithësi, ku fëmijët kanë rol më inferior se të rriturit që kryesisht i kanë punët në duart e veta dhe i menaxhojnë ato. Gjithashtu mendoj se si fëmijë, jo të gjithë janë të edukuar sa duhet për shumë tema dhe ende mësojnë nga jeta ndërsa rriten."

"Nuk mundën sepse nuk ka asgjë në fuqinë e tyre që ata mund të ndryshojnë."

"Fëmijët nuk kanë fuqi politike sepse nuk kanë të drejtë të votojnë, dhe ndryshimet bëhen nga politikanët."

"Sepse disa gjëra bëhen ashtu siç dëshirojnë të rriturit".

"Sepse nuk jemi pyetur për mendimin tonë."

"Askush nuk i dëgjon fëmijët."

"Sepse fëmijët shpesh lihen në prapavijë."

"Sepse fëmijët që do t'ju drejtohen nuk do dëgjoen".

"Sepse të gjithë mendojnë se fëmijët janë shumë të vegjël, të cilët ende nuk kuptojnë shumë gjëra dhe gjithçka që ata thonë është shaka."

"Unë mendoj kështu sepse as prindërit nuk na respektojnë kurrë fjalët dhe qëndrimet tona."

"Më shpesh sesa jo, kërkesat e tyre perceptohen si joserioze, dhe pikëpamjet dhe këmbëngulja e tyre nuk shprehen sa duhet - rasti i bojkotimit të testimit të jashtëm."

"Ata nuk janë aq të aftë për të ndryshuar disa gjëra sepse janë fëmijë dhe zëri i tyre shpesh shkon i papranuar dhe merret si një mendim i thjeshtë pa shumë rëndësi."

"Sepse të rriturit ende mendojnë se fëmijët nuk janë 'mjaft të pjekur' për të qenë në gjendje të veprojnë në tema më të rëndësishme."

"Sepse askush nuk do t'i dëgjojë ata pasi shumica e të rriturve mendojnë se fëmijët janë thjesht fëmijë dhe nuk do të ndryshojnë asgjë."

"Sepse mendimi i tyre ka pak vlerë në komunitet."

"Sepse për disa gjëra ata kanë nevojë për më shumë ndihmë."

"Sepse ata janë fëmijë dhe kanë nevojë për ndihmë për të bërë disa punë të vogla (rindërtimi në terren ose të ngjashme)."

"Nëse një fëmijë është i vetëdijshëm për diçka, që do të ndihmojë/ndryshojë jetën e tij (për mirë), do të thotë që mendimi i tij është shumë i rëndësishëm. Por meqenëse është fëmijë ai nuk do të ketë mbështetjen e të gjithëve."

"Konkretisht në vendin tonë fajtor është mentaliteti i popullit. Dhe ndërhyrja e politikës në gjithçka."

"Për shkak të situatës politike dhe ekonomike në vend."

"Sepse shteti nuk dëgjon për shumë gjëra, përfshirë edhe këtë."

"Shpesh, pa marrë parasysh se sa fëmijët kanë "zë të lartë" në shoqëri, institucionet veprojnë sipas dëshirës së tyre."

"Sidoqoftë, ne jetojmë në një shoqëri me paragjykime dhe fëmijë si individë nuk mund të ndikojnë në mendimet e njerëzve të tjerë që kufizojnë mundësitë e fëmijëve ose mendojnë se fëmijët nuk kanë të drejtat e tyre. Në atë rast, fëmijët duhet të shkojnë dhe të ankohen pranë institucioneve që kujdesen për të drejtat e tyre."

"Sepse fëmijët janë të vetëdijshëm se diçka po u ndodh atyre dhe duan ta ndryshojnë atë, por nga ana tjetër mendojnë se edhe nëse bëjnë diçka, situata nuk do të ndryshojë. "

" Disa fëmijë mund të flasin në publik, disa fëmijë mund të kenë jenë lënduar, kështu që kur flasin në publik të gjithë do ta dinë se çfarë ka ndodhur dhe pse, kështu që kur një i rritur e dëgjon atë do të vendosë të bëjë diçka në lidhje me të. Sidoqoftë, neve fëmijëve ndonjëherë nuk na besojnë, edhe kur na besojnë, ndonjëherë nuk do të kenë asnjë mënyrë për të na ndihmuar."

"Sepse unë mendoj se ata nuk janë të interesuar sa duhet, edhe nëse janë, mendimi i tyre për të ndryshuar disa gjëra nuk do të jetë i mjaftueshëm."

"Disa munden dhe disa nuk munden sepse varet nga problemi por edhe nga shpirti luftarak i fëmijës".

"Sepse nëse fëmijët mund të ndryshonin plotësisht gjërat, bota do të ishte e përkryer, për fat të keq, nuk është ashtu."

- **Shpjegimet se përse fëmijët janë të fuqishëm në bërjen e ndryshimeve:**

" Cilido fëmijë ka të drejtë të shprehë mendimin e tij dhe t'i njohë të drejtat e veta. Nëse ka padrejtësi, unë mendoj se komuniteti i fëmijëve mund të ankohet dhe ta ndryshojë atë."

"Me të drejtën e lirisë së shprehjes, lirisë së mendimit, vetëdijesimit dhe konfesionit, fëmijët janë të aftë të veprojnë për të drejtat e tjera, e disa t'i ndryshojnë."

"Nëse të rriturit munden, atëherë edhe fëmijët munden".

"Sepse çdo fëmijë ka të drejtë të luftojë për të ndryshuar gjërat që kanë rëndësi për të."

"I kuptojnë më mirë gjërat që u ndodhin dhe mund të japin argumente të forta me të cilat mund të fitojnë atë që dëshirojnë."

"Sepse vetë fëmijët janë dëshmitarë të problemeve të fëmijëve të tjerë, që të rriturit nuk i shohin si probleme."

"Pavarësisht nga mosha jonë, ne e dimë se çfarë është e drejtë për ne dhe se çfarë ndodh rreth nesh."

"Sepse ndërsa rriten, fëmijët fillojnë të mendojnë saktë për çdo vendim."

"Sepse ne fëmijët jemi shumë më të zgjuar se sa ata që mendojnë se jemi. Mos harroni historinë që Njeriu mëson derisa është gjallë."

"Cilido fëmijë është inteligjent në mënyrën e vet dhe ka mendimin e vet, që mund t'ju ndihmojë ata të ndjekin atë që duan, natyrisht me mbështetje, bashkëpunim dhe ndihmë."

"Sepse çdo fëmijë ka një potencial të madh."

"Unë mendoj se ne të gjithë kemi opinione për shumë gjëra dhe me këtë mund të përmirësojmë disa gjëra në shoqëri, natyrisht nëse do të na dëgjonin."

"Sepse ata gjithashtu kanë ide krijuese dhe zgjidhje."

"Kur jemi bashkë, jemi më të fortë."

"Unë mendoj se ata janë mjaft të fuqishëm sepse duke pasur qëndrim punën që është e rëndësishme për ta përmes mundit, duke grupuar më shumë fëmijë në organizata, mund të luftojnë për të ndryshuar gjërat".

"Edhe forca e fëmijëve është ka një nivel të caktuar, ka kufij deri të cilët mund të durojnë. "Por nëse bashkohen, janë shumë të fortë për të arritur qëllimin."

"Nëse doni, mund të bëni gjithçka."

"Të gjithë mund të ndryshojnë atë që është e rëndësishme për ta, dhe sot thuhet veçanërisht që bota i lihet rinisë."

"Sepse janë të fortë. Ndryshimi akoma do të vijë."

"Për të rritur ndërgjegjësimin për mjedisin tek njerëzit, të jenë shembull i respektimit të vlerave njerëzore ... në mënyrë që brezat pas nesh të jenë pjesë e një shoqërie që do t'u sigurojë atyre paqe, liri, dhe drejtësi."

"Gjithçka që duam, mund të arrijmë me ndoshta shumë përpjekje, por edhe shumë sukses. Mjafton të besojmë në veten tonë dhe të luftojmë pa hequr dorë, me këmbëngulje të madhe."

"Me vetëbesim të mjaftueshëm dhe mbështetje nga vetvetja dhe të dashurit tanë, ne do të jemi në gjendje t'i ndryshojmë njerëzit dhe mjedisin nëse punojmë për ta bërë atë të ndodhë."

"Fëmijët përhapin dashuri dhe miqësi".

"Mendoj se fëmijët mund të ndryshojnë gjithçka që dëshirojnë, sepse unë mendoj se kjo gjeneratë e fëmijëve janë të vetëdijshëm për problemet në shoqëri dhe nuk kanë frikë t'ju rezistojnë padrejtësive."

"Ne jemi një gjeneratë që mendoj se po zhvillohet më shpejt mendërisht, dhe kemi qasje në shumë platforma ku mund të shprehim mendimin tonë dhe të ndryshojmë disa gjëra në botë."

"Ka disa njerëz që duan të nënçmojnë fëmijët, por ju jeni këtu dhe shumë organizata të tjera për t'u thënë atyre njerëzve se fëmijët nuk janë të vetëm në këtë dhe se mundemi të arrijmë më shumë së bashku."

"Sepse ka organizata që kujdesen për mendimin e fëmijëve."

"Sepse në ditët e sotme ka ekspertë në fushën e të drejtave të fëmijëve."

TEMA 2:

MJEDISI SHKOLLOR

TEMA 2: MJEDISI SHKOLLOR

Pjesa e dytë e pyetësorit ka përfshirë një spektër të gjerë të pyetjeve për kushtet dhe relacionet me mjedisin shkollor, gjërat në të cilat fëmijët kënaqen, si dhe gjërat që konsiderojnë se duhet të ndryshohen ose përmirësohen.

2.1. Si e perceptojnë fëmijët shkollën?

Në pjesën fillestare të kësaj fushe tematike, të anketuarit patën mundësinë të përgjigjen se sa pajtohen me pohime të caktuara në lidhje me disa aspekte të mjedisit shkollor, dhe mesatarja aritmetike (M) është llogaritur për secilën prej pohimeve (shikoni tabelën 21). Një mesatare më e vogël aritmetike tregon marrëveshje më të madhe dhe anasjelltas.

Vërehet qartë se shumica e fëmijëve mendojnë se i përkasin shkollës së tyre, e konsiderojnë veten të respektuar nga nxënësit, mësimitdhënësit/profesorët dhe personeli tjetër i shkollës dhe do të drejtohen tek një mësues ose i rritur tjetër nëse nuk ndihen të sigurt.

Një pjesë e konsiderueshme e fëmijëve mendojnë se nuk i kushtohet vëmendje e mjaftueshme mirëmbajtjes së higjienës në shkollë, përfshirë higjienën në tualete, për shkak të së cilës disa nga fëmijët shmangin përdorimin e tyre.

Vetëm 1/3 e fëmijëve pajtohen plotësisht me deklaratën se ata janë të përfshirë kur marrin vendime në shkollën e tyre, ndërsa më shumë se gjysma pajtohen plotësisht me deklaratën që mësimitdhënësit/profesorët e tyre respektojnë mendimin e tyre.

Përgjigjet e fëmijëve ndahen në varësi të faktit nëse ata flasin me një psikolog, pedagog apo profesionist tjetër të shkollës kur ata kanë një dilemë apo problem. Shumica mendojnë se kujdestari i klasës i dërgon nxënësit tek psikologu ose pedagogu vetëm nëse kanë ndonjë problem.

Tabela 21: Për secilën prej fjalive tregoni sa pajtohesh.

	<i>Pajtohem</i>	<i>Pjesërisht pajtohem</i>	<i>Nuk pajtohem</i>	<i>M*</i>
<i>Nëse nuk ndihem i sigurt, mund të kërkoj ndihmë nga një mësimitdhënës/profesor ose nga një i rritur tjetër</i>	74.62%	20.21%	5.17%	1,31
<i>Ne kemi ujë të pijshëm në shkollë</i>	70.68%	16.82%	12.50%	1,42
<i>Ndihem sikur i përkas shkollës sime</i>	69.74%	26.41%	3.85%	1,34
<i>Kujdestari i klasës i dërgon nxënësit tek psikologu ose pedagogu vetëm nëse kanë ndonjë problem</i>	68.98%	22.74%	8.27%	1,39

<i>Nxënësit tjerë nga shkolla ime më respektojnë</i>	66.35%	30.45%	3.20%	1,37
<i>Mësimdhënësit/profesorët dhe tjerët që punojnë në shkollë më respektojnë</i>	62.97%	32.99%	4.04%	1,41
<i>Ndjem sigurt në shkollë</i>	58.46%	35.15%	6.39%	1,48
<i>Mësimdhënësit/profesorët e mi e respektojnë mendimin tim</i>	55.45%	38.16%	6.39%	1,51
<i>Atë që mësoj në shkollë është e dobishme dhe do të më ndihmojë në të ardhmen</i>	53.29%	40.23%	6.48%	1,53
<i>Mësimdhënësit/profesorët na motivojnë të mësojmë</i>	51.13%	37.31%	11.56%	1,60
<i>Mësimdhënësit/profesorët në secilën orë dëshirojnë të jenë të sigurt që e kemi kuptuar materialin</i>	50.00%	38.63%	11.37%	1,61
<i>Kënaqem kur jam në shkollë</i>	49.34%	43.14%	7.52%	1,58
<i>Në shkollën ime ka hapësirë mirë të pajisur për aktivitete sportive</i>	48.78%	33.83%	17.39%	1,69
<i>Në shkollën time dedikohet vëmendje e madhe higjienës (rregullisht pastrohen gjitha hapësirat)</i>	39.38%	45.86%	14.76%	1,75
<i>Kur kam ndonjë dilemë ose ndonjë problem, bisedoj me psikologun, pedagogun ose person tjetër profesional në shkollë</i>	39.19%	30.55%	30.26%	1,91
<i>Atë që mësojmë në orë shpesh është interesante</i>	34.40%	53.95%	11.65%	1,77
<i>Tualetet në shkollën time nuk janë të pastër prandaj shmang të shkojë tualet kur jam në shkollë</i>	34.02%	34.21%	31.77%	1,98
<i>Tualetet në shkollën time janë të pastër, ka mjete për higjienë, si për shembull, sapunë, letër tualeti, dhe rregullisht mbahen pastër</i>	30.26%	39.38%	30.36%	2,00
<i>Unë jam i/e kyçur kur merren vendime në shkollën time</i>	26.97%	40.70%	32.33%	2,05

2.2. Çfarë ju pëlqen fëmijëve, dhe çfarë mendojnë se duhet të ndryshohet në shkollën e tyre?

Me shumë pyetje të hapura të anketuarit kanë pasur mundësinë të ndajnë se cilat gjëra ju pëlqejnë në shkollën e tyre, si dhe çfarë mendojnë se duhet të ndryshojë. Fëmijët ishin

vendosur edhe në rolin e drejtorëve dhe kanë mundur të theksojnë se çfarë do të mund të bënin nga kjo pozitë.

Në mesin e arsyeve më të theksuara për të cilat fëmijët e duan shkollën e tyre numërohen ndjenja e përkatësisë dhe sigurisë, mundësitë për të mësuar, gjëra të reja, hapësira e rregulluar dhe higjiena, zgjedhja e madhe e aktiviteteve jashtë shkollore, stafi shkollor dhe shoqërimi me shokët.

Tabela 22 : E dua shkollën time pasi ... (ju lutemi plotësoni fjalinë)

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Ndihem si në shtëpi".

"Ndihem e sigurt dhe e rehatshme".

"Ndihem i mbushur me energji pozitive".

"Respektohen të drejtat tona"

"Mësimi i njohurive të reja".

"Më ofron arsim të mirë."

"Unë mësoj atë që më intereson, disa prej mësuesve na mësojnë shumë gjëra që nuk kanë lidhje me shkollën, ka miqësi".

"Mësoi shumë gjëra të dobishme që kanë qenë dhe do të jenë të dobishme në jetën time".

"Fakti që ekziston një mundësi për të aplikuar për projekte të ndryshme dhe aktivitete jashtëshkollore përveç orëve të rregullta. Shërbim i mirë psikologjik dhe pedagogjik që është këtu për disa nga problemet e studentëve."

"Pasi ka shumë aktivitete jashtëshkollore."

"Mësoj gjëra të reja, seksioni i dramës."

"Pastërtia brenda shkollës dhe oborrit".

"Oborri dhe atmosfera e bukur e shkollës".

"Higjiena, disiplinë".

"Pasi ka profesorë të mrekullueshëm".

"Shokët me të cilët jam rrethuar dhe disa nga personeli i shkollës."

"Gjëra të këndshme në të, për shkak të mësuesve dhe miqve".

Nëse do të ishin drejtor/drejtores, pjesa më e madhe e fëmijëve do të mundoheshin që të përmirësojnë relacionin e mësuesve/profesorëve ndaj nxënësve, do të punonin më

tepër për shëndetin mental të fëmijëve dhe do të siguronin që gjithë fëmijët të jenë të lumtur, të dashuruar dhe të sigurt, do të avancojnë edhe shëndetin fizik të fëmijëve me anë të afirmimit më të gjerë të sportit, pajisje më të mirë dhe më tepër orë të edukatës fizike dhe arsimit shëndetësor, do të kujdeseshin më tepër për higjienën në shkollë, do të përmirësonin cilësinë e arsimit dhe do të bënin orët më interesante, do të mundoheshin më tepër të komunikojnë me nxënësit dhe të përfshijnë ata në marrjen e vendimeve.

Tabela 23: Po të isha unë drejtor/drejtoreshë në shkollën time unë do kisha... (ju lutem, plotëso fjalën)

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Përpiqesha të bëj gjithçka për një arsim më të mirë të nxënësve në atë shkollë dhe për personelin, unë do t'i jepja stafit seminare të caktuara se si të kryejnë ligjërata të suksesshme."

"Ndryshoja disa profesorë".

"Mundohesha që profesorët të sillen ndryshe ndaj fëmijëve dhe me më shumë respekt. Megjithëse janë profesorë dhe jo të gjithëfuqishëm."

"Të gjithë fëmijët duhet të respektohen në mënyrë të barabartë."

"Kisha luftuar që çdo fëmijë të gjejë vendin e vet dhe të jetë i lumtur".

"Sigurohesha që të gjithë fëmijët të kenë të drejtat e njëjta."

"Isha kujdes më shumë për shëndetin mendor të studentëve."

"Isha munduar ta bëj shkollën më të mirë në çdo aspekt, në të cilin nxënësit do të ishin ndjerë të dashur dhe të sigurt."

"Isha siguruar që shkolla të ishte higjienike".

"Kisha ushtruar më shumë kontroll mbi higjienën e tualeteve".

"Kisha zbatuar higjienë më të mirë në të gjithë shkollën, mësuesit të mund t'i ndihmojnë fëmijët të mësojnë më mirë duke i motivuar ata dhe duke siguruar festa shkollore gjatë gjithë vitit që fëmijët të argëtohen dhe të shoqërohen".

"Isha përpjekur ta bëj orën interesante për fëmijët dhe orlët me lëndë profesionale të kenë aktivitete."

"Isha përpjekur të bëja mësimin e fëmijëve ta bëj më interesant."

"Kisha vendosur më shumë pajisje për FSSh".

"Kisha qëndruar për afirmimin e sportit dhe ekipeve sportive të shkollave."

"Kisha vënë më shumë orë edukatë fizike në një javë."

"Isha siguruar që nxënësit të shpreheshin më lirshëm dhe të përfshiheshin sa më shumë që mundej në aktivitete që lidhen me përgjegjësitë e shkollës ."

"Përpiqesha t'i dëgjoja ata dhe të ndajnë këshilla me nxënësit e mi."

"... kisha folur me më shumë nxënës se si ndjehen, shpesh do të pyesja nxënësit për mendimin e tyre mbi mësuesit."

" Kisha realizuar aktivitete që nuk kanë të bëjnë me mësimin."

" ... kisha organizuar disa takime konsultimi dhe anketime me nxënësit, do kisha organizuar punëtori pjesërisht të detyrueshme, ku nxënësit nga klasa të ndryshme do të ndanin ide për aktivitete të reja, do të nxitnin pjesëmarrjen dhe zhvillimin e shumë aktiviteteve dhe projekteve."

"Rampë stabile për qasje."

"Isha përpjekur të rris numrin e librave në bibliotekë që nuk duhet të lexohen."

"Kisha vendosur dollapë në korridor ose klasë, që nxënësit të mund të linin gjërat e tyre."

"Kisha vendosur më shumë rend dhe disiplinë në shkollë."

"Isha kujdesur për disiplinën e nxënësve."

"Do të ndëshkoja ashpër fëmijët që kryejnë dhunë fizike dhe psikologjike ndaj nxënësve të tjerë, do të siguroja uniforma të përshtatshme dhe të detyrueshme (sepse veshja e markës zvogëlon vetëbesimin e fëmijëve të caktuar), do të organizoja aksione humanitare, do të ndërtoja një kantinë, çdo individ që ketë sukses të shkëlqyeshëm do të shpërblehej me para, do të punësoja profesorë të përshtatshëm të informatikës dhe teknologjisë sepse kjo është e ardhmja e botës."

Tabela 24: Çfarë mendoni se duhet të ndryshoni në shkollën tuaj?

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Mendoj se më shpesh duhet të zhvillohen sondazhe të nxënësve, mbi atë se çfarë u pëlqen dhe çfarë nuk u pëlqen në mësimdhënie, vështirësitë me mësuesit dhe stafin dhe në përgjithësisht në shkollë."

"Më shumë të dëgjohej nxënësit për disa nga problemet e tyre."

"Ndryshimi është më shumë të respektojmë fëmijët! Sepse ka mësues që fyejnë fëmijët".

"Prezantimi i rampave për karroca invalidësh, klasa me pajisjet e duhura për çdo lëndë, higjienë më të mirë në tualetet, më shumë shporta për plehra."

"Duhet të ketë instrumente në klasën e arsimit muzikor që nxënësit do mund të përdorin instrumentet për argëtim dhe relaksim, duhet të ketë televizorë ku ato do të shikonin filma në klasa të posaçme si relaksim pas orëve të rregullta."

"Për të përmirësuar kushtet për sport dhe aktivitete sportive dhe për të blerë më shumë kompjuterë."

" Llambat, tavanin, kompjuterë, dysshemetë, oborrin."

"Bankat dhe karriget."

"Higjienë më të madhe në tualetet."

"Disa profesorë dhe qasja e tyre, si dhe presioni ndaj fëmijëve kinse notat na ndërtojnë si njerëz dhe stresin që e krijojnë."


"Mendoj se duhet të shtohen më shumë orë edukative, siç është muzika dhe disa orë të tilla interesante që do të tërheqin vëmendjen e fëmijëve."

"Më shumë aktivitete jashtëshkollore."

2.3. Si ndjehen nxënësit dhe të punësuarit ndaj fëmijëve të grupeve të ndryshme?



Shumica e të anketuarve besojnë se shumica e nxënësve dhe të rriturve në shkollën e tyre i trajtojnë të gjithë fëmijët njësoj, pavarësisht nga përkatësia etnike, vendbanimi ose statusi financiar i familjes së tyre. Sidoqoftë, një pjesë e konsiderueshme (35.62%) mendojnë se fëmijët nga familje më të pasura gëzojnë një marrëdhënie më të mirë me nxënësit dhe të rriturit.

Figura 25: Si sillen pjesa më e madhe e nxënësive dhe të rriturve në shkollën tuaj ndaj:



2.4. A ka në shkollat kushte përkatëse për fëmijë me aftësi të kufizuar?

Vetëm 28.67% e nxënësve theksojnë që në shkollat ka rampë për ngjitje me karroce, ndërsa 19,50% që ka ndihmës që ju ndihmon fëmijëve me aftësi të kufizuar gjatë orëve (shikoni figurën 26). Pjesa më e madhe e të anketuarve mendojnë që mësimitdhënësit mjaft ju ndihmojnë personave me aftësi të kufizuar në shkollë (shikoni figurën 27).



TEMA 3: KOHA E LIRË


TEMA 3: KOHA E LIRË

Fusha e tretë e pyetësorit kishte të bëjë me kohën e lirë të fëmijëve, përfshirë edhe nëse kanë kohe të mjaftueshme, si e përdorin, si dhe nëse kanë kushte përkatëse për sport, çlodhje, aktivitete kulturore dhe tjera në vendbanimin e tyre.

3.1. Si e përdorin fëmijët kohën e tyre të lirë?


Gjysma e nxënësve mendojnë që çdoherë kanë kohë të lirë për aktivitetet në të cilat kënaqen.

Figura 28: A ke mjaft kohë për të bërë aktivitetet të cilat të kënaqin?



Por, pjesa më e madhe (64.07%) theksojnë që kohën e lirë e kanë të kufizuar për shkak të detyrave të tepërt të shtëpisë dhe obligime tjera shkollore. Për 6.85% të nxënësve koha e lirë është e kufizuar për arsye tjera mes të cilave theksojnë punë plotësuese, hobi, ndihmë në shtëpi, dhe tjera.

Figura 29: Kohën e lirë e kam të kufizuar sepse:



Pothuaj se 80% e fëmijëve kanë kushte për pjesëmarrje në aktivitetet në të cilat kënaqen në vendbanim (shikoni figurën 30), por theksojnë që shumë gjëra mungojnë si sipërfaqe të gjelbër, vende për sport dhe çlodhje, aktivitete kulturore dhe edukative (shikoni tabelën 31). Fëmijët që jetojnë në mjedise rurale dhe qytete më të vogla kanë theksuar mungesën e kushteve, aktiviteteve dhe vendeve ku ata do të kalonin kohën e lirë. Një pjesë e fëmijëve mendojnë që në vendin e tyre të banimit nuk ka mjaft njerëz dhe fëmijë tjerë me të cilët do të shoqëroheshin, dhe do të bënin aktivitete tjera në të cilat kënaqen.




Tabela 31: Ajo që mungon në vendbanimin tim është ... (Shtoni).
Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Më shumë ngjarje kulturore dhe trajnim edukativ për fushat që na interesojnë."

"Shtigje biçikletash".

"Ski terrene".

"Pishina".

"Librari."

"Kinema".

"Më shumë hapësira për sport dhe rekreacion".

"Më shumë terrene për sporte dhe më shumë parqe apo sheshe lojërash për fëmijë të vegjël."

"Salla sportive".

"Park. Në vend që të ndërtojmë ndërtesa që do të jenë bosh për disa vjet, mund të ndërtohet një park i vogël."

"Park për fëmijë"

"Vende interesante për shoqërim."

"Kinema, teatër, hapësirë e sigurt për çiklizëm, palestër që do të jetë e hapur për këdo që dëshiron të luajë sport".

"Vende ku mund të zhvillojmë artin, dhoma leximi, vende për relaksim, pishina, etj."

"Nuk ka hapësirë që fëmijët të luajnë, gjithashtu ka vetëm dy kafene dhe dyqane, kështu që nuk kemi zgjidhje tjetër përveç që të kaloni kohën tuaj në vende tjera përveç parkut."

"Epo, gati gjithçka më mungon sepse jetoj në fshat."

"Jetoj në fshatin Katlanovë dhe nëse e vizitoni ndonjëherë do të shihni që është një vend shumë i vogël ku ka vetëm shtëpi dhe nuk ka vend ku fëmijët mund të ulen dhe të dëfrehen. Nuk ka parqe, kafene, shitore sanduiçësh, furra buke ..."

"Gjithçka është e vogël dhe ka pak shtëpi, por qyteti është mjaft afër, kështu që shpesh bëj aktivitete në qytet."

"Shtëpi e kulturës me më shumë aktivitete për fëmijë mbi 15 vjet, t'i kushtojnë vëmendje çdo fëmije, edhe atyre nga fshatrat dhe jo vetëm nga qytetet."

"Qytet i vogël .. Nuk ka park ... Kinema ... Teatër ... Hapësira për sporte ..."

"Ajo që mungon në vendbanimin tim janë njerëzit."


"Njerëzit."

"Mungojnë shokët."

"Më shumë fëmijë".

Më shpesh, fëmijët e kalojnë kohën duke u shoqëruar me shokët jashtë shtëpisë, duke dëgjuar muzikë ose në mediat sociale. Shumë pak është përqindja e atyre që vizitojnë ngjarje kulturore, kinema, orë private për muzikë dhe shëtitje të kafshës shtëpiake.

Figura 32: Në tabelën më poshtë shënoni sa shpesh keni bërë secilën prej aktiviteteve si zakonisht.




Aktivitete tjera të cilat i bëj shpesh/ndonjëherë/rrallë janë:

Më poshtë janë dhënë një pjesë e përgjigjeve të fëmijëve

33. shpesh	34. ndonjëherë	35. rrallë
Fitnes Kërcim Këndim	Shëtitje në natyrë Përpunimi i stolive Ecje	Udhëtim Ndihmë në obligimet e shtëpisë Shikim i televizionit


Vizatim Futboll Ecje në mal Orë për aktrim Shkuarja e ditarit Notim Pjesëmarrje në aktivitete të organizatave joqeveritare dhe të shkollave Shëtitje me shokë Luajtje në kompjuter	Lexim i librave Vozitje të rolerëve Vullnetarizëm	Vizitë e bibliotekës Gatim
--	---	-------------------------------

3.2. A kanë dhe sa kanë mundësi fëmijët për sportim?



Gjysma e fëmijëve theksojnë që në vendbanimin e tyre ka mjaft klube sportive dhe aktivitete sportive (shikoni figurën36). Të anketuarit mendojnë që ka më tepër faktorë që ndalojnë fëmijët të marrin pjesë në aktivitete sportive, mes të cilëve më të rëndësishme janë shpenzimet e mëdha dhe koha e kufizuar. Frika që nuk do të jenë të suksesshëm në sportin dhe

mungesa e shoqërisë për vizitë të aktiviteteve sportive gjithashtu janë pengesa për disa prej fëmijëve (shikoni figurën37).



Dëshira për jetë të shëndoshë, duke të mirë, arritje të suksesshme sikur idhujt e tyre sportiv, mundësitë për argëtim, shoqërim dhe relacione të mira të trajnerëve janë mes gjërave që më shpesh i motivojnë fëmijët të marrin pjesë në aktivitete sportive.

Tabela 38: Çfarë mendoni se i motivon fëmijët të marrin pjesë në aktivitete sportive? (Shëno)
Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Dëshira për një jetë të shëndetshme."

"Shoqëria dhe pamja e shëndetshme dhe e mirë."

"Dëshira për pamje të mirë, miqësi me bashkëmoshatarët, inkurajim nga prindërit."

"Ndoshta nëse kanë një person të famshëm që ju duket interesante, ata motivohen nga mendimi se një ditë do të jenë të famshëm si ata dhe se do të jenë po aq të suksesshëm."

"Suksesi i një skuadre, për shembull RK Vardar, kështu që sipas atyre lojtarëve që i kanë idhuj, fëmijët dëshirojnë të stërviten në disa prej shkollave të Vardarit, gjithashtu edhe vetëdija se është e shëndetshme të merreni me sporte etj."

"Se ata do të bëhen të suksesshëm në atë pjesë të sportit. Do të marrin pjesë në shumë gara."

"Qëndrimi i trajnerëve."

"Qasja pozitive nga trajneri dhe mungesa e zhvlerësimit të fëmijëve femra/meshkuj nëse ata ushtrojnë sporte" mashkullore/ femërore". "

"Të shoqërohen dhe të argëtohen".

"Ka shumë përfitime nga sporti, si fitimi i kondicionit, puna në ekip, besimi te shokët e skuadrës (nëse është një sport ekipor), dashuri dhe respekt më i madh për veten dhe të tjerët, vetëbesim dhe humor më të mirë. "Por gjëja më e rëndësishme për fëmijët, mendoj, është argëtimi dhe e qeshura në kohën e kaluar duke luajtur me fëmijët e tjerë."

"Dashuria për sportin".

"Njoh shumë fëmijët, ku përfshijë edhe veten, që kemi dashur të jemi atletë por ajo u lejohej vetëm fëmijëve nga qyteti sepse kishim kohë të caktuar për transport, gjithashtu doja të shkoj në kor por isha në fshat dhe për këtë arsye nuk kisha mundësi të trajnoj zërin tim ose të mësojë t'i bie ndonjë instrumenti."

TEMA 4:


**SHËNDETI DHE CILËSIA
E JETËS**

TEMA 4: SHËNDETI DHE CILËSIA E JETËS

Fusha e katërt e pyetësorit ka përfshirë pyetje për më tepër aspekte lidhur me shëndetin dhe cilësinë e jetës së fëmijëve, përfshirë edhe pyetje për shëndetin e tyre fizik dhe mental, ushqimin, qasjen në shërbime shëndetësore dhe varfëria fëmijërore.


4.1. A mendojnë fëmijët që zhvillojnë jetë të shëndoshë?

Përqindja më e madhe e fëmijëve mendojnë se ushqehen shëndetshëm (72.47%), flenë mjaftueshëm (81.91%) dhe janë aktive në aktivitete fizike (70.36%).




4.2. Çfarë ushqimi konsumojnë fëmijët kur janë në shkollë?


Kur janë në klasë, pjesa më e madhe e fëmijëve (63.33%) çdo ditë blejnë ushqim nga shitoret/furra/sandviçë lokale, por një pjesë konsumojnë ushqim të siguruar nga shkolla ose të përgatitur në shtëpi. Për 1/5 e fëmijëve njëherë ose dy herë në javë ju ndodh që mos të hanë kur janë në shkollë.



Për pjesën më të madhe të fëmijëve (51.88%) ushqim i përditshëm në shkollë është një lloj i brumit (gjevrek, byrek, kiflet, etj.). Një pjesë e caktuar e fëmijëve në baza ditore konsumojnë ushqim të shpejtë (39.27%), ushqim i lehtë (38.02%) ose diçka të ëmbël si çokolatë, biskotë, kollac e tjera (42.83%). Më tepër se gjysma e fëmijëve asnjëherë nuk hanë perime, ndërsa më tepër se 1/3 asnjëherë nuk janë pemë kur janë në shkollë.




Por, nota mesatare në shkallë prej 1 deri 5 tregon se fëmijët nuk janë të kënaqur nga sasia, llojllojshmëria dhe cilësia e ushqimit që konsumojnë.



4.3. Si ndjehen fëmijët dhe a bisedojnë me dikë për ndjenjat e tyre

Pjesa më e madhe e të anketuarve shpesh ndjehet e dashuruar, me disponim dhe i sigurt në vete, sesa pa disponim, pikëlluar ose shqetësuar. Pothuaj se gjysma e fëmijëve ndjehen të dobishëm çdo ditë, ndërsa 1/10 janë nën stres çdo ditë.

Figura 43: Në tabelën janë fjali për atë si ndjehesh gjatë tre muajve të fundit dhe për secilën fjali zgjidh sa shpesh ndjehesh ashtu?



Gjysma e fëmijëve bisedojnë me dikë për ndjenjat e tyre, posaçërisht kur janë të pikëlluar ose të shqetësuar (shikoni figurën 44) dhe ato shpesh janë anëtarë të familjes më të afërt ose miq të ngushtë, dhe jo shpesh flasin me persona profesional (shikoni tabelën 45). Më tepër se 1/3 e fëmijëve dëshirojnë të bisedojnë me dikë për ndjenjat e tyre, dhe pothuaj se 1/10 preferojnë të shkruajnë ndjenjat e tyre në ditar, rrëfim ose vjerdhë në vend që të flasin me dikë. Një përqindje e vogël e fëmijëve nuk kanë me kë të bisedojnë.

Figura 44: A ndjehesh lirë për të biseduar për ndjenjat e tua (posaçërisht kur ndjehesh i/e pikëlluar ose shqetësuar)?




Tabela 45: Nëse je i/e shqetësuar në shkollë, a di ndonjë të rritur në shkollë me të cilin/ën mund të flasësh?

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Po, unë njoh shumë njerëz me të cilët mund të flas dhe ata janë fqinjët e mi, miqtë e mi dhe të tjerë që jetojnë aty pranë."

"Po, me gjyshërit".

"Po, me mikun tim më të mirë".

"Po, prindërit e mi, por jo gjithmonë u flas atyre për këtë."

"Po, me prindërit e mi".

Po, unë shpesh flas sinqerisht dhe hapur me disa nga miqtë e mi më të afërt për ndjenjat e mia, dhe ata gjithashtu flasin me mua për vetë e tyre, dhe kurrë nuk jam penduar për këtë, mendoj se ata gjithashtu."

"Po, me prindërit ose vëllezërit e mi".

"Nëse jam i mërzhitur për ndonjë arsye mendoj se duhet t'u drejtohem prindërve ose shokut më të afërt."

"Po, prindërit, të afërmit, miqtë."

"Prindër, miq, nuk kam turp nëse kam nevojë të kërkoj këshilla nga një profesionist (psikolog , psikiatër)".

"Miq, prindër, psikolog."

"Prindër ose psikolog."

4.4. Mbrojtja shëndetësore dhe sociale

Fëmijët theksojnë që kanë dëgjuar ose personalisht njohin bashkëmoshatar që nuk kanë marrë ndihmë përkatëse ose me kohë mjekësore për probleme me shëndetin fizik dhe publik, si dhe këto raste janë më të shpeshtë nga fillimi me pandeminë COVID-19.

Tabela 46: A dini apo keni dëgjuar për ndonjë fëmijë që nuk ka marrë ndihmë mjekësore, kur ka pasur nevojë? Përshkrani.

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Unë nuk di rast specifik, por kam dëgjuar që ata që nuk kanë sigurim shëndetësor nuk marrin ndihmë."

"Do ditë ka disa raste kur fëmijët vdesin nga sëmundje të rënda sepse nuk kanë mjete financiare për trajtim."

"Çdo ditë dëgjoj për fëmijë të sëmurë që nuk e kanë kujdesin e duhur mjekësor. Kjo shkel të drejtën për kujdes shëndetësor për fëmijët."

" Po. Padyshim vajza që vdiq nga skolioza disa vite më parë."

"Kam dëgjuar për Tamara që vdiq sepse nuk u lejua të merrte mjekim jashtë vendit në kohë."

"Ishte një vajzë e lënduar, cilës fondi nuk ia pagoi operacionin, kështu që i gjithë qyteti mblidhte para për atë operacion."

"Depresioni dhe nuk pranoi ndihmë".

"Në komunën tonë ka një fëmijë që ka probleme mendore dhe askush nuk po e ndihmon atë."

"Po. Kur personeli ose nuk mund ose nuk dëshironte ta shërbente dhe e dërgonte nga një departament tjetër."

"Po. Kohët e fundit, një person i afërt u diagnostikua me një sëmundje të rrallë autoimmune, për të cilën dermatologut iu desh 5 minuta që të bëh një ekzaminim nën një llambë speciale . Përgjigja e mjekut ishte që të vinte të nesërmen, edhe pse ishte urgjente."

"Po. Një incident kur një fëmijë me një prind ishte në ambulancë, fëmija ishte i sëmurë dhe duhej të merr antibiotikë, por mjeku i tij i familjes nuk ishte në detyrë në atë moment dhe prindi e pyet infermierin nëse mjeku tjetër mund ta ekzaminojë atë edhe pse nuk është pacienti i saj, ajo refuzoi dhe fëmija i sëmurë me prindi kthehen në shtëpi."

" Po. Kushëriri im shpesh ankohej për dhimbje në stomak. Ai ishte në spital disa herë dhe si ilaç mjekët i thanë të pinte çaj. Pas një kohe, i "shpërtheu" zorra e verbër dhe duhej të bënte një operacion."

"Po, u trajtua në baza natyrale, me të ashtuquajtura "ilaçe përralore"."

"Kam dëgjuar që shumë fëmijë nuk kanë marrë ndihmën e nevojshme. Për shembull, këto ditë në kohën e koronës, kishte një fëmijë që vdiq ndërsa prindërit e tij thërrisnin ambulancën dhe nuk kanë pasur automjet të lirë."

"Për shkak të kësaj gjendje, shumë fëmijëve dhe të rriturve nuk u ishte ofruar ndihmë mjekësore për krah ose këmbë të thyer, etj."

"Po. Kur fëmija kishte dy kocka të thyera në kokë dhe nuk u pranua sepse ishte pozitiv për virusin Covid 19."

Fëmijët ndajnë një sërë shembujsh të rrethinës së tyre me bashkëmoshatarët e tyre që jetojnë në varfëri dhe nuk kanë kushte elementare për jetesë, ndërsa mungon kujdesi përkatës nga ana e institucioneve dhe që zakonisht për këtë grup të fëmijëve sigurohet ndihmë me anë të aksioneve humanitare.

Tabela 47: A njihni apo keni dëgjuar për ndonjë fëmijë që nuk ka shtëpi të ngrohtë, ushqim të mjaftueshëm, ujë, rroba të pastra, mjete higjienike, apo ndonjë gjë tjetër e nevojshme për një jetë të mirë? Përshkruani se çfarë saktësisht mungon dhe nëse dikush e ka ndihmuar atë.

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Po, unë kam dëgjuar, dhe i kanë ndihmuar njerëz (të njohur ose të panjohur), por jo nga shteti apo institucionet që janë të përgjegjshëm për këtë."

"Ka shumë fëmijë që lypin në Shkup që nuk kanë shtëpi të ngrohtë dhe askush nuk u jep dashuri dhe kujdes. Njerëzit tanë janë me të vërtetë mizorë dhe rrallë u lënë para fëmijëve të tillë. Unë mendoj se ata nuk janë aq të arsimuar sa duhet që të merren me fëmijë të tillë, për t'i ndihmuar ata."

"Kam dëgjuar dhe në televizion dhe në qytet për fëmijë që janë të detyruar nga prindërit e tyre të punojnë, lypin, ndonjëherë edhe vjedhin. Ata nuk kanë higjienë të mjaftueshme, nuk kanë shtëpi të ngrohtë, rroba, ushqim dhe dashuri prindërore. Ka njerëz që i ndihmojnë, por rrallë."

"Kam dëgjuar për shumë fëmijë të tillë, ata zakonisht nuk kanë ushqim ose shtëpi të ngrohtë. Ndoshta ju ndihmojnë kalimtarët me 5, 10 denarë secila, por askush nuk shqetësohet sa duhet për ta".

"Po, në klasën e parë, një vajzë shumë e varfër mëson me ne. Tash më nuk mëson me ne dhe nuk e di se çfarë ndodhi, por askush nuk e ndihmoi."

"Një shok klase i shkollës fillore pa burime të mjaftueshme për një jetë normale. Mblodhëm para nga e gjithë klasa dhe kështu e ndihmuam."

"Një shoqe, i ndihmuam të gjithë duke mbledhur para për mjete të ndryshme higjienike dhe arsimtarët sollën rrobat e fëmijëve të tyre dhe ia dhuruan".

"Një shok i imi i shkollës fillore. Nëna e tij është në karrocë invalidësh dhe ai nuk kishte para për të paguar diplomimin e tij. Tani nuk e di se si është nuk kam asnjë kontakt me të."

"Unë njoh një fëmijë që stërvit me mua në një klub sportiv dhe shumë shpejt humbi të dy prindërit. Gjyshërit e tij nuk ishin në gjendje të kujdeseshin për të, por të gjithë mblodhëm para për ta ndihmuar, siç bëri edhe klubi. Tani ai jeton një jetë të lumtur me dajën e tij."

"Po, kam dëgjuar, u mungon ushqimi, rrobat, shtëpia ..., ndihmohen nëpërmjet organizatave humanitare dhe mbledhjes së fondeve dhe donacioneve nga rrjetet sociale."

"Njoh disa fëmijë që nuk kanë mjaft rroba të pastra dhe mjete higjienike dhe shpesh ndihmohen nga njerëzit në vendbanimin tim."

"U organizuan disa aksione humanitare për fëmijë nga disa qytete, për të cilët u dhuruan ushqim, rroba, batanije, pajisje shtëpiake, etj. Dhe qytetarë nga i gjithë vendi dhuruan për ta."

"Kam dëgjuar dhe ndihmuar, falë Kryqit të Kuq DKKV. Gjatë programit RCA-PVH, ne si vullnetarë ishim të ngarkuar me organizimin e ngjarjeve humanitare për të mbledhur fonde që më vonë u përdorën për të siguruar ushqime dhe artikuj higjienik për një familje sociale."

"Po, një fëmijë nga lagja ime që kishte shtëpi por nuk kishte ku të flenë, nuk kishte për ushqim, nuk hante me ditë ... Dhe gjithë fëmijët dhe disa të rritur dhuruan fonde për të dhe për shtëpinë."

"Në shkollën time fillore, shpesh organizoheshin aksione humanitare, në të cilat mblidhnim ushqim dhe rroba për fëmijë me nevoja të veçanta, fëmijë nga jetimore ose për fëmijë nga shkolla jonë, të cilët nuk janë materialisht të siguruar sa duhet."


TEMA 5:
MJEDISI JETËSOR

TEMA 5: MJEDISI JETËSOR


Kjo temë e pyetësorit ishte dedikuar problemeve nga fusha e mjedisit jetësor me të cilën përballohen fëmijët, si dhe pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

5.1. Me çfarë probleme ekologjike përballohen fëmijët?

Më tepër se gjysma e të anketuarve kanë sipërfaqe të sigurta ose të pastra publike në afërsi, ndërsa pothuaj se 1/3 mendojnë që sipërfaqet e gjelbër në afërsinë e tyre nuk janë të pastër dhe të sigurt.



Për 2/3 e fëmijëve problemi me ajrin e ndotur, posaçërisht gjatë periudhës së dimrit është situatë ditore (shikoni figurën 49). Fëmijët theksojnë që ajri i ndotur në masë të madhe ndikon mbi shëndetin e tyre fizik dhe mental, e kufizon funksionimin e tyre të përditshëm dhe i detyron që pjesën më të madhe të kohës së tyre të kalojnë mbyllur në shtëpitë e tyre. Një pjesë e fëmijëve theksojnë që vetëm më



janë të mësuar të jetojnë në ato kushte dhe që ajri i ndotur nuk ndikon në jetën e tyre të përditshme ose në disponimin e tyre. Por, fëmijët janë të shqetësuar për efektin negativ të ajrit të ndotur mbi familjarët dhe personave tjerë në vend që kanë probleme shëndetësore.

Tabela 50: Si ndjeheni kur ajri është i ndotur dhe si ndikon ajo në jetën tuaj të përditshme? Përshkruaj
Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Nuk mund të marr frymë."

"Më shkakton vështirësi në frymëmarrje dhe në disa raste më lotojnë sytë".

"I paralizuar, me frymëmarrje të ndërprerë, ndjenjë e shpifur."

"Ndiej plogështi dhe dobësi, më dhemb stomaku."

"Ndihem i lodhur".

"Sëmurem".

"Kam shumë probleme me alergjitë dhe ajri i ndotur gjithmonë më ndikon në këtë."

"Ndihem keq. Prindi im ka bronkit kronik dhe e gjithë situata me ajrin ndikon keq tek ai dhe ia dëmton shëndetin e tij. Kjo më shqetëson edhe më tej. Ndikon edhe tek unë, jam vazhdimisht i bllokuar dhe nuk mund të marr frymë".

"Kam disa probleme shëndetësore dhe ajri i ndotur më vështirëson akoma më shumë frymëmarrjen."

"Më parë jo, por këtë dimër pata një problem me frymëmarrjen. Disa herë nuk mund të merrja frymë dhe isha i detyruar të mbaja maskë dhe të shkoja për inhalacion gjatë gjithë kohës te mjeku i familjes, ambulanca e të cilit nuk është afër vendbanimit tim. Dhe me këtë, prindërit e mi kishin shumë më tepër shpenzime shtesë për mua dhe shëndetin tim gjatë asaj periudhe."

"Për shkak se ajri i pastër duhet të jetë një mik i pandashëm i jetës sonë të përditshme, ajri i ndotur ndikon menjëherë në traktin respirator: vështirësi në frymëmarrje, ulje në ritmin e frymëmarrjes, nxitje për zhvillimin e patologjive të ndryshme të traktit respirator ose sistemeve të tjera të organeve, dhe në vetvete paraqet një pengesë në përmbushja e përgjegjësive tona të përditshme."

"Ndjehem sikur kam pak oksigjen dhe shpesh ndiej marramendje duke shkuar në një destinacion të caktuar. Kam probleme me shikimin dhe frymëmarrjen."

"Keq, shpesh kam bronkit dhe sa herë shkoj në fshat me familjen time sepse ajri atje është i pastër dhe kjo më ndihmon të shërohem më shpejt."

"Keq".

"Ndikon në shëndetin tim".

"Depresive."

"Nuk ndjehem i lumtur dhe ndonjëherë shqetësohem".

"Ndjehem e tensionuar dhe ndikon negativisht tek unë."

"Është e pakëndshme".

"Shqetësuar."

"Më ngulfat. Dhe kjo nuk më bën të lumtur".

"Nuk ndjehemi shëndetshëm dhe nuk kam dëshirë të dal për shëtitje dhe ngjashëm."

"Më pak dalje jashtë, ftohje më të shpeshta".

"Nuk mund të hap dritare ose të dal sepse më ngulfat."

"Ndhem si një mi eksperimental, me një fjalë: keq, sepse nuk mund të lëviz lirisht, nuk mund të marr frymë dhe duhet të kufizoj lëvizjen time për shkak të ndotjes së lartë".

"Ndjem sikur jetoj në një kambanë sepse rrallë dal jashtë dhe më duhet të mbaj maskë".

"Keq sepse ndërhy në funksionimin e përditshëm, dhe ndotja ndikon gjithashtu në shëndetin e njerëzve."

"Është e vështirë të marrësh frymë dhe të shohësh se si ndikon në përgjegjësitë e përditshme. Është më e vështirë të kryesh përgjegjësitë dhe disa nuk kryhen fare."

"Më duhet të mbaj një maskë mbrojtëse jashtë dhe kjo më bën të zemërohem".

"Shumë më shqetëson ajri i ndotur sepse më ngulfat dhe nuk duroj dot erën."

"Kur dal me miqtë e mi në vjeshtë ose dimër ose kur kthehem në shtëpi nga shkolla, ajri shpesh është i ndotur, kështu që ndikon në erën e trupave tanë, dhe veçanërisht flokët."

"Ndhem shumë keq. Kur ka mjegull duhet të jem shumë i kujdesshëm sepse asgjë nuk është e dukshme. Më duhet më shumë kohë për të arritur në shkollë dhe shtëpi".

"Nuk mund të marr frymë mirë, nuk kam energji, është e vështirë të shihet për shkak të mjegullës së trashë, etj."

"I paaftë për të bërë diçka."

"Krijon nervozizëm dhe ndjenja të pakëndshme. Është faktori kryesor që më bindi mua të lë atdheun tim në të ardhmen."

"Jemi mësuar me të dhe kjo nuk ndikon tek ne".

"Nuk kam asnjë lloj ndjenje. Duhet të kryejë detyrat e mia çdo ditë, pavarësisht nëse ajri është i ndotur apo jo".

"Nuk i kushtoj shumë vëmendje kësaj."

"Nuk është më ndryshe, sepse ne kemi jetuar në atë mënyrë me vite dhe jemi mësuar me të".

"Ndonjëherë gjatë dimrit ka tym, dhe gjatë verës erë nga ferma lokale, por nuk ndikon aq shumë."

"Unë e di se është i ndotur dhe nuk është i mirë për shëndetin tim, por nuk është diçka e veçantë për të cilën duhet të kujdesem më në detaje."

"Sinqerisht nuk kam një ndjenjë të veçantë për ajrin e ndotur, por më shqetëson që fëmijët e vegjël dhe adoleshentët kalojnë nëpër të".

"Pak i shqetësuar për njerëzit që kanë probleme shëndetësore, por në përgjithësi nuk kam frikë dhe nuk shqetësohem për veten time."

Përveç ajrit të ndotur, fëmijët theksojnë edhe disa probleme tjera ekologjike në vendbanimin e tyre, si sipërfaqe të papastër, ndotja e ujit dhe dheut, jeshile të pamjaftueshëm, fabrika në afërsi të vendbanimeve që lëshojnë materie të dëmshme, deponi të pakontrolluar, djegia e mbeturinave, miniera dhe mungesa e vetëdijes ekologjike në vend.

Tabela 51: A ka probleme të tjera me mjedisin në vendin tuaj? (Shënoni)

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Ka shumë mbeturina gjithandej nëpër rrugë , sipërfaqe të gjelbër, ujë, etj."

"Mbeturinat e hedhura në rrugë dhe lëndina."

"Ka shumë mbeturina në oborrin e shkollës."

"Ka shumë mbeturina përreth vendit tim."

"Po, shumë mbeturina hidhen në hapësirat për lojëra."

"Ka shumë njerëz të pakulturuar që hedhin mbeturina dhe bishta cigaresh kudo."

"Shpesh hedhin mbeturina jashtë kontejnerëve që rezulton në përhapjen e erës së keqe."

" Numri i koshave për plehra, veçanërisht koshave për objekte të ndryshme bërë nga materiale të ndryshme për riciklim."

"Nuk ka numër të mjaftueshëm të koshave për plehra. Shkatërrimi i koshave ekzistues për plehra. Shkatërrimi i këndeve të lojërave për fëmijë nga qytetarë të paskrupull."

"Po, duke djegur plehra dhe mbeturina tjera."

" Ndonjëherë digjet deponia e qytetit."

"Uji i pijshëm dhe uji i lumenjve janë të ndotur, dhe shumë shpesh nuk ka ujë."

"Po. Ujë i ndotur (lumenjtë), ajri, toka."

"Prerja e drunjtëve".

"Fabrikat që lëshojnë substanca të dëmshme."

"Dhe për shembull, lindani në Ohis ."

"Njerëzit nuk kanë vetëdije për mjedisin."

"Vetëdija e pazhvilluar tek njerëzit për ndotjen".

"Deponitë e paligjshme".

"Mini deponitë nga njerëz të tmerrshëm që nuk kujdesen për mjedisin".

"Nuk ka drurë dhe gjelbërim të mjaftueshëm"

"Ka sepse ndërtohen shumë ndërtesa aty ku nuk duhet, veçanërisht para një ndërtese tjetër ose në vendin e një parku që kontribuon për ndotjen e ajrit".

"Ndërtesat janë ndërtuar në të gjitha hapësirat e gjelbra."

"Kishim një park të bukur, por tani është shkatërruar për të ndërtuar një hotel ... Nuk mendoj se kishte nevojë për hotel, mundeshin vetëm të pastronin."

"Miniera."

"Po, ka. Njerëzit përreth nuk janë plotësisht të vetëdijshëm për ndotjen e natyrës duke hedhur mbeturina në tokë. Mbeturinat janë kudo, dhe unë përpiqem sa të mundem që të rris ndërgjegjësimin e të paktën miqve të mi që të mos hedhin mbeturina përreth dhe vazhdimisht i kujtoj ata të marrin mbeturinat që kanë lënë në tokë dhe ta hedhin në koshin më të afërt për plehra."

"Ajri i ndotur, uji i ndotur, shumë mbeturina në rrugë, ndërtim i paligjshëm dhe shkatërrimi i plazheve, prerja e kallamishteve në liqen dhe mbingarkesa e gjahut dhe e peshkimit."

5.2. A kanë marrë dhe sa kanë marrë pjesë fëmijët në aktivitete për mbrojtjen e mjedisit jetësor?

Pjesa më e madhe e fëmijëve (62.80%) kanë marrë pjesë në ndonjë aktivitet për mbrojtjen e mjedisit jetësor (shikoni figurën 52.1). Prej përgjigjeve të fëmijëve mund të vërehet që pjesa më e madhe e këtyre aktiviteteve (p.sh. riciklim të plastikës, pastrim i sipërfaqeve publike, mbjellje) janë të organizuar nga shkollat (shikoni tabelën 52.2).

Figura 52.1: A ke marrë pjesë në ndonjë aktivitet ekologjik?




Tabela 52.2: Shpjegoni se në çfarë aktiviteti keni marrë pjesë.

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Aktivitete shkollore për pyllëzim dhe pastrimin e mjedisit."

"Nëpërmjet shkollës, pastruam parkun në afërsi të shkollës."

" Në aktivitetet ekologjik të shkollës që kishte të bëj vetëm me shkollën tonë."

" Mbjellja e pemëve dhe pastrimi i oborrit të shkollës."

"Patrulla mjedisore kur isha në shkollë fillore."

"Në pastrimin e shkollës dhe mbjelljen e drurëve dhe luleve ".

"Mbjellim drurë për ditën e drurit dhe një herë pastruam oborrin me mësuesit."

"Në më shumë aktivitete mjedisore për të pastruar ose promovuar një jetë të shëndetshme dhe mjedis të shëndetshëm."

"Grumbullimi i mbeturinave në sipërfaqe publike dhe shpërndarja e fletushkave për të rritur ndërgjegjësimin".

"Në një projekt për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për ndryshimet klimatike dhe pastrimin."


"Disa herë kemi pasur aktivitete mjedisore nga Dega Komunale e Kryqit të Kuq".

"Grumbullimi i mbeturinave, pyllëzimet dhe rregullimi i hapësirave të gjelbra, mbledhja dhe riciklimi i plastikës."

"Pastrimi i mbeturinave, mbledhja e plastikës, qelqit dhe letrës dhe pyllëzimet."

Mes aktiviteteve ekologjike të cilat më shpesh i organizojnë shkollat janë edhe aksione për zbukurim të oborrit me mbjellje të druve dhe luleve. Shkollat nuk kanë shumë seksione ekologjike me të cilat zbatohen aktivitetet ose organizojnë ligjërata nga persona të jashtëm në temat e mbrojtjes së mjedisit jetësor.

Figura 53: Çfarë dhe sa shpesh shkolla jote zhvillon aktivitete për të mbrojtur dhe ruajtur mjedisin jetësor?



TEMA 6:
SIGURIA DHE REHATIA


TEMA 6: SIGURIA DHE REHATIA

Kjo pjesë e pyetësorit ishte dedikuar pyetjeve lidhur me sigurinë e fëmijëve, me fokus në sigurinë në vendbanimin e tyre, si dhe përvojave të fëmijëve me çdo lloj të dhunës.

6.1. Sa ndjehen të sigurt fëmijët?

Në shkallën prej 1 deri 5, fëmijët në kuadër të mestrarë ndjehen të sigurt në shtëpi dhe në shkollë. Fëmijët ndjehen më pak të sigurt në lagjen e tyre, si dhe në internet.

Figura 54: Në shkallë prej 1 deri 5, gjatë së cilës 1 është më pak sigurt, dhe 5 është më shumë sigurt, sa ndjehesh sigurt:



Fëmijët theksojnë që përqindja e ulët e krimit, njohja e fqinjëve dhe relacionet e mira mes fqinjëve, si dhe prania e nëpunësve policor kontribuojnë që ata të ndjehen të sigurt në vendin e tyre të banimit.

Tabela 55: Çfarë ju bën të ndjeheni të sigurt në vendbanimin tuaj? (Shënoni)

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Është qytet i vogël, të gjithë e njohim njëri-tjetrin dhe kemi një marrëdhënie të mirë me njëri-tjetrin."

"Jam i rrethuar nga njerëz që më japin besim."

"Afërsia midis njerëzve".

"Të dashurit e mi, të cilët janë gjithmonë pranë meje".

"Dashuria e pakushtëzuar e prindërve të mi."

"Nëna dhe babai im dhe gjyshërit e mi që janë pranë."

"Kam fatin të jetoj në një vend mjaft të sigurt, në qytet ku nuk ka shumë dhunë apo vjedhje ..."

"Ka një përqindje të vogël të dhunës dhe pothuajse të gjithë e njohim njëri-tjetrin dhe kemi krijuar marrëdhënie të mira miqësore."

"Nuk ka raste të shpeshta vjedhjesh, djegie të paligjshme të ndërtesave, vrasje, etj."

"Kam vetëbesim dhe i njoh fqinjët e mi. Ndonjëherë shëtitin edhe policë dhe ne mundemi t'u drejtohem atyre."

"... Ndërtesa ime është ngjitur me një stacion policie."

"Zona të ndriçuara, zonë me popullsi të dendur."

"Rrugët janë të ndriçuara, unë jetoj afër një stacion policie, kështu që zyrtarët policorë shpesh kalojnë aty".

Nga ana tjetër, qentë e rrugës që lëvizin nëpër rrugët janë një prej arsyeve kryesore që i bënë fëmijët të ndjehen të pasigurt në vendin e tyre të jetesës, përveç mungesës së ndriçimit në rrugë, prania e dhunës dhe numri i tepërt i veturave (shikoni figurën 56.1). Vozitja e shpejtë e veturave si dhe prania e personave në gjendje të alkoolizuar janë faktorë që shqetësojnë fëmijët dhe prindërit e tyre. Në disa raste prindërit vendosin që kufizojnë lëvizjen e fëmijëve për të mbrojtur ata (shikoni tabelën 56.2).

Figura 56.1: Çfarë të bën që mos të ndjehesh i/e sigurt në vendbanimin tënd? (mund të rrethosh më tepër përgjigje)




Tabela 56.2: Çfarë ju bën të ndjeheni të pasigurt në vendbanimin tuaj? (Mund të rrethoni më shumë përgjigje)

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve që u përgjigjën "tjetër".

"Nuk mendoj se jam shumë e sigurt sepse ka shumë njerëz që natën janë të dehur dhe unë kam frikë prej tyre, nuk mund të bëj sport sepse prindërit e mi kanë frikë dhe nuk do të më lënë të shkoj."

"Ngjatja tepër e shpejt e makinave në rrugët e qytetit. Prania e qenve endacak në lagje."

"Shërbimi joadekuat policor."


"Disa njerëz që janë agresivë dhe kanë nevojë për dhunë."

"Mbledhja e njerëzve të paskrupullt në orët e vona të mbrëmjes."

"Njerëzit e besimit dhe kombësisë tjetër na ndalojnë me vetura. Unë mendoj se ky është një problem serioz dhe është koha që dikush të ndërmerë diçka. Gjithashtu nuk kemi një linjë autobusi deri në orën 10, duhet të shkojmë në këmbë ose me taksì".

6.2. Përvoja e fëmijëve me dhunën

Figura 57: A ke qenë ndonjëherë viktimë e dhunës familjare?



10% e fëmijëve të përfshirë në hulumtim theksojnë që ndonjëherë kanë qenë viktimë e dhunës (shikoni figurën 57). Fëmijët më shpesh theksojnë shembuj të dhunës mes moshatarëve në shkollë ose vendbanimin e tyre (shikoni tabelën 57.2).

Tabela 57.2: A keni qenë ndonjëherë viktimë e dhunës? Nëse mundeni, përshkruani se kush e ka kryer dhunën, ku (në shtëpi, në rrugë, në shkollë, etj.) ka ndodhur dhuna, çfarë lloj dhune ka qenë (fizike, në internet, fyerje, thashetheme, përjashtim nga një grup, etj.) dhe si keni vepruar ju.

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Si më i ri, në shkollë fillore, ka më shumë gjasa që fëmijët t'i kopjojnë sjelljen shtëpiake nga prindërit e tyre dhe ka ndodhur që unë të futem në një rrahje, e cila nuk ka pasur pasojë të tmerrshme."

"Në baza ditore kam qenë viktimë e dhunës verbale nga shokët e mi të klasës. Profesorët nuk ndërmorën asgjë edhe pse ishin të vetëdijshëm për atë që po ndodhte."

"Një shoqe nga shkolla më lidhi këmbët dhe më bëri të gjunjëzohem sepse nuk mbaja mend se në cilin skuadër futbollit duhet të shkoja. Kjo ishte gjatë edukatës fizike. Derisa një shoqe tjetër i tha asaj që të mos më bënte atë. Pasdite i tregova nënës time dhe ajo bisodoi me nënën e vajzës dhe mësuesen. Nuk ndodhi përsëri pas kësaj, por prapë kam një përvojë të pakëndshme."

"Disa nga miqtë e mi u sulmuan në një autobus dhe në rrugë pa asnjë arsye."

"Unë mendoj se të gjithë ne kemi qenë viktima të ndonjë lloj dhune të paktën një herë në jetën tonë. Përvoja ime personale është tallja me peshën dhe pamjen time. Përqeshje kur shpreh mendimin tim i cili është i ndryshëm nga mendimi i të tjerëve."

"Dhuna psikologjike në shkollë. Kam duruar shumë ofendime dhe tallje. Nuk bëra asgjë, thjesht e pranova, e injorova dhe vet u rregullua."

"Shpesh më kanë përqeshur, ka pasur thashetheme dhe të ngjashme nga bashkëmoshatarët e mi në shkollë dhe në lagje, por jam mësuar me të dhe shumicën e kohës thjesht i shmang ato, por nëse e teprojnë unë mbroj veten time dhe ata ndalen të paktën për një kohë, dhe ndonjëherë pas kësaj nuk më ngacmojnë fare. Gjithashtu çdo ditë më fyejnë në shtëpi."

"Më shumë më ndodhte në internet kur dikush filloi të më kërcëronte me pasojë, duke më ndaluar të flisja me 'të dashurën' e tij dhe shoqen time të klasës."

Më tepër se 20% e fëmijëve njohin ndonjë që ka qenë viktimë e dhunës (shikoni figurën 58.1), ndërsa 25% kanë ndihmuar dikë që ka qenë viktimë e dhunës (shikoni figurën 59).





Tabela 58.2: A njihni ndonjë që ka qenë viktimë e dhunës? Nëse mundeni, përshkruani se kush e ka kryer atë, ku (në shtëpi, në rrugë, në shkollë, etj.) ka ndodhur dhuna, çfarë lloj dhune ka qenë (fizike, në internet, fyerje, thashetheme, përjashtim nga një grup, etj.) dhe si keni vepruar ju.

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Fyerje në rrjetet sociale dhe shkrimi i gënjeshtreve nga njerëz anonimë që lëndojnë disa familje, si dhe bashkëmoshatarët e mi që më vonë u ngacmuan nga bashkëmoshatarët e tyre."

"Në shkollë ka dhunë ndaj fëmijëve që nuk mund vet të mbrohen."

"Një shoqe e përbuznin për peshën e saj dhe ajo u dhunua fizikisht, e goditën dhe e hodhën në shkurre. Gjithashtu e fyen atë përpara simpatisë."


"Dhuna fizike në oborrin e shkollës, nuk kam ndërhyrë sepse kam qenë shumë më i vogël se fëmijët në konflikt"

"Vrasja e dy adoleshentëve në rrethinën time nga persona të armatosur."

"I dashuri i shoqes time ishte duke e abuzuar psikikisht, sepse ishin nga qytete të ndryshme, kryesisht me fyerje, kërcënime përmes Internetit ose telefonit."

"Vazhdimisht kam parë si shpërndajnë thashetheme dhe fyerje pas shpinës, dhe gjithashtu në internet për persona që njoh. Shumica e incidenteve kanë ndodhur në shkollë dhe në rrugë."

Figura 60: A ke qenë në situatë, për ndonjë arsye, të lëndosh dikë?



13% e fëmijëve theksojnë që janë gjetur në situatë të lëndojnë dikë dhe ajo shpesh ka qenë në vetëmbrojtje ose në mbrojtje të shokut/shoqes, si dhe kur kanë qenë nervoz ose të inatosur dhe nuk kanë ditur të kontrollojnë këto ndjenja, dhe ju ka ndodhur që pa dashje të lëndojnë dikë në mënyrë verbale (tabela 60.2).

Tabela 60. 2: A jeni gjendur ju, për ndonjë arsye, në situatë që të lëndoni dikë? Nëse mundeni, shpjegoni.

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Kam lënduar ndjenjat e dikujt me fjalët e mia gjatë vetëmbrojtjes."

"Disa herë kur dikush më ka ngacmuar dhe është përpjekur të më sulmon fizikisht, unë u mbrojta dhe i lëndova, pas kësaj asnjëri prej tyre nuk më trajtonte më ashtu."

"Në vetëmbrojtje, një person sulmoi fizikisht një tjetër dhe unë ndërhyra për të ndihmuar. Një djalë po abuzonte fizikisht motrën time dhe unë isha në një situatë që ta lëndoja."

"Ishte në vetëmbrojtje. Unë vetëm e shtyva."

"Kur isha më e re kisha një shoqe dhe ajo tërë kohën ngacmonte dikë, na shkulte flokët, na pickonte kot dhe më pas do të qeshte. Një herë erdhi dhe më shkuli flokët shumë fortë dhe nisi qeshë, unë u nervozova shumë dhe nuk mendova, ia shkula edhe unë flokët dhe ajo më goditi, unë e gërvishta, ajo më pickoi dhe kështu ne vazhduam derisa erdhi mësuesja."

"Nga nervozizmi."

"Isha në shkollë fillore dhe nuk dija si ta kontrolloja zemërimin tim."

"Jo me qëllim, kur nuk isha në humor të mirë."

"Fyerje në baza etnike, por pa qëllim".

"Ndoshta me një fjalë nuk kam dashur ta them por e kam thënë."



"Gjatë një keqkuptimi me një mik "

"Mundohem të mos përfshihem në grindje dhe zënka."

"Nuk e mbaj mend, por jam i sigurt që të paktën një herë, të paktën pa vetëdije, ia bëra dikujt për të mbrojtur dikë, shpesh përpiqem të mos lëndoj njeri, madje as ndjenjat e dikujt tjetër."

"Doja të mbroja dy persona që ishin duke debatuar, por në fund unë u lëndova".

Pothuaj se 1/4 e fëmijëve theksojnë që njohin bashkëmohatar që të dhënat, fotografi ose video janë vendosur në internet pa pëlqimin e tij/saj, ndërsa në 8% ajo personalisht ju ka ndodhur (figura 62). Nëse dikush i keqtrajton në internet, ose i keqpërdor të dhënat personale të tyre, pjesa më e madhe do të drejtohen familjes (76.75%) dhe në polici (59.72%), ndërsa 28.42% do të drejtoheshin në Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (shikoni figurën 63).



TEMA 7: DISKRIMINIMI

TEMA 7: DISKRIMINIMI

Grupi i fundit i pyetjeve kanë të bëjnë me përvojën e fëmijëve me diskriminimin.

Një pjesë e caktuar e fëmijëve janë ndier të diskriminuar në një situatë të caktuar (shikoni figurën 64), dhe shpesh si arsye përmendet mosha, gjinia, si dhe gjendja financiare e familjes së tyre (shikoni figurën 65.1). Fëmijët gjithashtu theksojnë që kanë qenë të diskriminuar edhe për shkak të dukjes së tyre, peshës trupore dhe ngjyrës së lëkurës, vendit të banimit, stilit e veshjes ose muzikën që dëgjojnë (shikoni tabelën 65.2).





Tabela 65.2: Arsyet e tjera pse fëmijët u diskriminuan.

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Pesha e trupit , kilogramët e tepërta."

"Kompleksi fizik, praninë e qimeve trupore dhe ngjyra e lëkurës."

"Pamja, pesha pak më e madhe, mendimi që mësuesit e mi më lejojnë më shumë sende se sa duhet."

"Ngjyra e errët e lëkurës për shkak të së cilës përdornin emra nënçmues."

"Kur isha më i vogël, disa fëmijë më quanin trashe ose lepur për shkak të trupit dhe dhëmbëve."

"Dashuria për artin dhe pamja ime."

"Për shembull, kur ata thonë që ju jeni një femër dhe duhet të kujdeseni për gjithçka. Ose kur nuk do të më marrin seriozisht sepse unë jam 'e vogël'."

"Shumë burra të panjohur më trajtuan në mënyrë të padrejtë sepse jam femër."

"Jam diskriminuar disa herë sepse jam femër dhe stërvitë basketbollin."

"Fëmijë i fshatit".

"Që nuk jam nga i njëjti qytet."

"Jam diskriminuar shpesh nga miqtë e mi të shkollës që jetojnë në qytet, sepse shpesh shkoj tek gjyshërit e mi në një fshat ku kam shumë miq dhe ndihem mirë. Por kur kthehem në qytet, ata shpesh më quajnë fshatar ose kërcënojnë të mos rri me mua vetëm sepse unë i kaloj pushimet e mia verore në fshat dhe kthehem në shtëpi më së shumti një herë në muaj. Dhe ata nuk janë të vetëdijshëm se gjatë vitit shkollor unë jam me ta gjatë gjithë kohës dhe nuk kam mundësi të shoh miqtë e mi nga fshati që janë shumë të ndryshëm sepse kur kam mundësi të shkoj në fshat ata janë të lumtur që shkoj t'i shoh dhe çdo minutë e kalojmë në lojëra dhe të qeshura, ndërsa kur kthehem në qytet kaloj një javë të tërë duke diskutuar me miqtë e mi nga shkolla pse shkova në fshat në vend që të kërceja jashtë dhe të rrija me ta. Dhe shpesh pyes veten nëse ata janë me të vërtetë miqtë e mi sepse i dua dhe i respektoj tepër shumë, thjesht nuk ndjehem sikur dashuria dhe respekti më janë kthyer në të njëjtën sasi."

"Një shok i klasës më përqeshi sepse familja ime kishte një makinë më pak prestigjioze."

"Doja të shkoja në një turne por nuk munda për shkak të financave."


"Lloji i muzikës që dëgjoj dhe mënyra se si unë mendoj se nuk është tipike për shumë nga bashkëmoshatarët e mi, kështu që ata shpesh më përqeshin"

"Sepse në situata të caktuara jam dalluar më shumë nga njerëzit që nuk e kanë pritur atë nga unë (p.sh. në shkollë), të njëjtët njerëz kanë ndryshuar mënyrën se si komunikojnë me mua."

"Nuk më kanë pranuar gjithmonë për shkak të mënyrës së veshjes dhe muzikës që dëgjoj".

"Për shkak të origjinës së nënës sime."

"Mosha e prindërve të mi".



Më tepër se 1/3 e fëmijëve kanë qenë dëshmitarë të diskriminimit (figura 66.1). Fëmijët sqarojnë që në disa raste nuk kanë reaguar për shkak të frikës, kanë qenë të vegjël dhe kanë menduar se nuk janë në gjendje të ndihmojnë. Në raste tjera fëmijët janë kundërshtuar personit që ka diskriminuar, dhe në numrin më të vogël ka ardhur në përleshje fizike. Fëmijët gjithashtu ndajnë që janë drejtuar për ndihmë

mësimdhënësve/profesorëve ose personave profesional në shkollë dhe kanë biseduar, i kanë qetësuar dhe i kanë inkurajuar fëmijët që kanë qenë të përqeshur ose diskriminuar.

Tabela 66.2: A keni dëshmuar diskriminim? Nëse po, si reaguat?
Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Nuk reagoja sepse kisha frikë të kundërshtoja shumicën e nxënësve që kanë diskriminuar dikë."

"Nuk reagoja sepse isha e vogël."

"Nëse kam ndjerë se nuk do mund të ndihmoj dhe nuk doja të përfshihem në argument, atëherë qëndroja anësh dhe bisedoja/ngushëlloja personin që ishte i diskriminuar. Por nëse ndihem i sigurt dhe "i fuqishëm" që të përfshihem, atëherë do të jem patjetër në krah të personit të diskriminuar."

"Kundërshtova fëmijën që ishte diskriminues."

"Qëndroja pranë një shoku që ishte i diskriminuar dhe i kundërshtonte të tjerët".

"U sqarova atyre se ajo mund të ndikon shumë keq te ai person dhe se ata duhet të ndalen."

"U thashë atyre që të ndalojnë një marrëdhënie të tillë, sepse të gjithë jemi njerëz dhe të barabartë, dhe nuk është e drejtë të diskriminojmë kundër tyre për çfarëdo baze."

"Duke filluar një diskutim rreth asaj se si është e mundur të diskriminohet dhe si do të ndjehej nëse do t'i ndodhte".

"U zemërova shumë dhe bisedova me mikun tim se nuk ishte e përshtatshme që ai ta bënte atë."

"Miq të përqeshnin me një fëmijë me autizëm duke mos ditur se ishte i tillë. Unë u sqarova atyre se unë e dija gjendjen e tij dhe u kërkova që të mos sillen ashtu, por të pranojnë të ndryshmen nga ne. Ata e bënë atë dhe isha shumë i kënaqur."

"Diskriminim për shkak të paaftësisë dhe unë reagoja duke u thënë atyre se ne të gjithë jemi të njëjtë, në gjak dhe mish, dhe pavarësisht nga pamja që është e ndryshme për disa, të gjithë jemi nga i njëjti Zot."

"I/e hidhëruar".

"Kam rrahur fëmijën që fyhu mikun tim se ai nuk kishte para dhe ishte cigan."

"Jam shoqëruar dhe e kam ngushëlluar fëmijën".

"Kishim një rome në klasën tonë, në klasën e 5-të dhe e thërrisim maxhupe shpesh dhe unë i thashë asaj që atëherë të mos brengoset dhe të mërzitet, të mos e regjistrojë fjalën sepse ato janë të këqija dhe duan të lëndojnë."

"Shpesh flas me vajzën në klasë e cila po diskriminohet, duke e bërë atë të mos ndjehet keq."

"Vajza ishte e trashë dhe të gjithë thanë se nuk mund të ngjitej dhe e demotivuan. Ne shkuam së bashku dhe unë i thashë asaj - si ti dhe unë e kam të vështirë, por ne do të kemi sukses së bashku".

"Po, kishte një fëmijë në shkollën time që kishte situatë të rëndë financiare në familje. E fyenin, dhe unë si dëshmitar së bashku me miqtë e mi dhe u ankuam te profesoresha dhe u morën masa."

"U përpoqa t'i tregoja personit se ky qëndrim ishte shumë i gabuar, sepse kjo ndodhi në shkollë, bisedova me një mësues, si dhe me personin që ishte diskriminuar".

"Raportova te pedagogu në shkollën time."

Vetëm 6% janë përgjigjur që vetë ata kanë diskriminuar dikë (shikoni figurën 67.1), kur kanë qenë të vegjël por nuk kanë qenë të vetëdijshëm se mund të lëndojnë me ato fjalë, por edhe për ndikim të fëmijëve tjerë me të cilët janë shoqëruar (shikoni tabelën 67.2).




Tabela 67.2: A keni kryer diskriminim ndaj ndokujt? Nëse mund të shpjegoni.

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Në një kohë apo një tjetër në fëmijërinë tonë, të gjithë kemi qenë të prirur ndaj diskriminimit dhe nuk mund ta mohoj këtë, por nuk ka ndodhur shpesh dhe për një kohë të gjatë. Tani nuk ndodh aspak."

"Për shkak të njohurive të pamjaftueshme, kam diskriminuar njerëzit për shkak të pamjes së tyre, kombësisë."

"Për shkak të papjekurisë sime".

"Isha e vogël dhe nuk isha e vetëdijshme që mund të lëndoja njeri me fjalë të tilla."

"Mendoj se po dhe kjo është arsyeja pse pendohem shumë, nuk do të doja të flas për këtë sepse kam turp sinqerisht dhe ndjej faj."

"Mendoj se disa herë si fëmijë kam qenë pjesë e një grupi njerëzish që kanë diskriminuar verbalisht ndaj një fëmije tjetër, dhe unë vetë përfundimisht kam fyer ndonjëherë dikë me qëllim, megjithëse gjatë gjithë jetës time jam përpjekur shumë të jem një person i mirë dhe në mënyrë të barabartë t'i trajtojme të gjithë me kulturë."

"Isha në shoqëri të keqe dhe ata më tërhoqën zvarrë në të."

"Asnjëherë nuk kam diskriminuar ndaj askujt në bazë të orientimit seksual, fesë, ngjyrës së lëkurës ose gjinisë."

"Kurrë nuk kam diskriminuar dhe kurrë nuk do të jem në gjendje të diskriminoj askënd për shkak të dallimeve të tyre."

**TEMA 8:
INFORMACIONE
PLOTÈSUEESE**

TEMA 8: INFORMACIONE PLOTËSUESE

Në pjesën e fundit, fëmijët kanë pasur mundësi që të ndajnë diçka që ata konsiderojnë se është e rëndësishme, por nuk është përfshirë në pyetësonin. Një pjesë e fëmijëve kanë theksuar që ka probleme me cilësinë e arsimit, diskriminimi aktual i grupeve të caktuar, si dhe nevoja për informim të fëmijëve për të drejtat e tyre. Disa prej komenteve përmbajnë ide për pyetje të cilat janë parashtruar, shprehje të kënaqësisë për pjesëmarrje në pyetësonin dhe interes që të mësojnë më tepër për atë nëse dhe si ky hulumtim do të kontribuojë për përmirësimin e jetës së fëmijëve.

Tabela 68: Dëshironi të shtoni diçka që kemi harruar të pyesim?

Më poshtë janë disa nga përgjigjet e fëmijëve.

"Mendoj se gjithçka është në vend dhe gjithçka është e përfshirë. Më vjen mirë që isha pjesë e këtij sondazhi. Do të doja të isha pjesë e një organizate të tillë për të ndihmuar fëmijët dhe njerëzit në përgjithësi."

"Jo, shpresoj se ky informacion do t'ju ndihmojë shumë."

"Jo. Më pëlqeu shumë sondazhi dhe mendoj se sondazhe të tilla duhet të bëhen më shpesh për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës."

"Bëni më shumë kontrolle në mesin e fëmijëve në shkollë dhe më shumë rend, sepse procesi arsimor në Maqedoni është në nivelin më të ulët dhe gjeneratat tona do të jenë më të paaftë për shkak se mungon kontrolli/frika/ashpërsia."

"Pse është shkatërruar arsimi, dhe me këtë rast dua të nderoj profesoreshën më të përkushtuar të psikologjisë në jetën time ... , nëse të gjithë profesorët do të ishin aq të përkushtuar sa kjo GRUA për arsim gjeneratat e ardhshme do të ishin të pathyeshme dhe plot njohuri."

"Dua të shtoj se tani që jemi në një kohë krize, kemi shumë, shumë më tepër përgjegjësi sesa mësuesit, të cilat nuk kemi kohë t'i përfundojmë të gjitha sepse janë shumë. Kishim orë mësimi deri në ora 1 pasdite dhe pastaj do ulëshim në kompjuterë deri në mbrëmje dhe bënim detyrat, gjë që nuk është e mirë për sytë tonë."

"Në vendin tonë, fëmijët romë diskriminohen posaçërisht, i përqeshin dhe ju shmangen".

"Si ndjehen të rinjtë dhe adoleshentët dhe si do të kishin trajtuar fëmijët me orientime të ndryshme seksuale dhe komunitetin LGBT."

"Mendoj se duhet të merren masa për diskriminimin e komunitetit LGBT. Shumë nga bashkëmoshatarët e mi janë ngacmuar sepse nuk janë heteroseksualë dhe janë përbuzur për orientimin e tyre seksual dhe shpesh nuk pranohen as nga prindërit e tyre."

"Dua të shtoj se në shkollë duhet t'u tregohet më shumë fëmijëve mbi të drejtat e tyre."

"Disa fëmijë me të vërtetë kanë nevojë për ndihmë, por ose ata nuk e dinë se ku të drejtohen ose kanë frikë t'i besojnë dikujt. Unë mendoj se çdo fëmijë duhet të shkojë te një psikolog të paktën një herë në javë."

"Dua që mendimi i fëmijëve të jetë më i rëndësishëm në botën e të rriturve."

"Fëmijët nuk janë arsimuar sa duhet për seksin, orientimin seksual, marrëdhëniet që ndërtojmë dhe ngjashëm."

"Çfarë na motivon/demotivon në këtë shoqëri?"

"A mendoni se në botë, meshkujt ende preferohen më shumë sesa femrat?"

"Për shkak se shkollat fillojnë në orën 8, jo në orën 10, për shembull, dhe ne nuk kemi kohë për të fjetur."

"A ndikon muzika tek fëmijët/adoleshentët dhe si ndikon?"

"A janë të lumtur?"

"A jemi të kënaqur me mësuesit/profesorët tanë ..."

"Unë dua të di nëse kjo do të ndryshojë ndonjë gjë."

"A mendoni se ky sondazh 10-minutësh do të ndryshojë ndonjë gjë?"



PËLQIMI NGA PRINDI/KUJDESTARI PËR PJESËMARRJE NË HULUMTIM

Kush jemi ne?

Organizata jonë quhet Ambasada e Parë për Fëmijë në Botë Megjashi, ose shkurt Megjashi. Puna jonë e përditshme është të përmirësojmë të drejtat e fëmijëve në Maqedoni dhe në botë. Mes parimeve kryesore të punës së Megjashi-it janë nxitja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe dëgjimi i mendimit të tyre për çështje që i prekin ato. Mund të gjeni më shumë informata mbi ne [këtu](#).

Pse zhvillohet ky hulumtim?

Megjashi aktualisht zhvillon studime mbi situatën me të drejtat e fëmijëve në afërsinë e vendbanimit të tyre, si dhe në vend në përgjithësi.

Prandaj, pikëpamjet e fëmijëve janë jashtëzakonisht të rëndësishme për ne dhe duam të dimë më shumë rreth përvojës së tyre dhe perceptimit të të drejtave të fëmijëve, problemet me të cilat përballen fëmijët dhe gjërat të cilat ata mendojnë se duhet të përmirësohen.

Hulumtimi zhvillohet për fëmijët e moshës 12 deri në 17 vjeç.

Çfarë kërkohet prej fëmijës tim?

Me pëlqimin tuaj, dëshirojmë ta ftojme fëmijën Tuaj të merr pjesë në këtë hulumtim. Për ta bërë këtë, fëmija juaj do të duhet të përgjigjet në një pyetësor në internet i përbërë nga 68 pyetje. Do të duhen rreth 40-45 minuta për të plotësuar pyetësorin. Pyetësori u përgatit nga të rritur nga Megjashi dhe një grup prej 30 fëmijëve nga disa komuna.

Pasi të jepni pëlqimin për pjesëmarrje, Ju lutemi të keni parasysh faktin se fëmija duhet në mënyrë të pavarur të plotësojë pyetësorin.

Çfarë do të ndodh me përgjigjet e fëmijës tim?

Përgjigjet e këtij pyetësori do të na ndihmojnë të përgatisim raporte që do të tregojnë pasqyrën e vërtetë të situatës me të drejtat e fëmijëve. Ne do të bëjmë çmos që raportet të jenë në dispozicion të sa më shumë njerëzve dhe vendimmarrësve, në mënyrë që t'i informojmë ata për problemet dhe t'i motivojmë që të bëjnë ndryshime.

Raportet do t'i paraqiten Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve në

nëntor 2020. Raporte të ngjashme janë bërë në vitin 2010 dhe mund të shihen këtu: [raport nga fëmijët](#), [raport nga OJQ-të](#).

Gjithashtu, përgjigjet për secilën pyetje do t'na ndihmojnë shumë në planifikimin e veprimtarive të ardhshme të Megjashi-it që do të çojnë në kushte më të mira dhe respektim të të drejtave të fëmijëve në Maqedoni.

Ne askujt nuk do t'i zbulojmë identitetin e fëmijës suaj. As emri juaj e as emri i fëmijës suaj nuk do të përmenden në asnjë produkt të shkruar.

A është e domosdoshme që fëmija im të merr pjesë në këtë pyetësor?

Pjesëmarrja në këtë pyetësor është vullnetare, që do të thotë se fëmija juaj do të marrë pjesë vetëm nëse dëshiron dhe nëse ka pëlqimin tuaj. Pyetësi është gjithashtu anonim, që do të thotë se nuk keni nevojë të shkruani emrin dhe mbiemrin tuaj, dhe ne nuk do ta dimë se kush ka dhënë çfarë përgjigje.

Nuk keni pse të pajtoheni me pjesëmarrjen e fëmijës tuaj në këtë hulumtim nëse nuk dëshironi. Në rregull është edhe nëse thoni JO. Fëmija juaj gjithashtu ka të drejtë të thotë JO, nëse nuk dëshiron të marrë pjesë, pavarësisht nëse ju jepni pëlqim për pjesëmarrjen e tij/saj. Ju dhe fëmija juaj gjithashtu keni të drejtë të ndryshoni mendim dhe të mos merrni pjesë në hulumtim në çdo kohë. Nëse vendosni të mos merrni pjesë, nuk do të ketë ndikim mbi fëmijën/fëmijët tuaj.

Kë mund të kontaktoni për pyetje lidhur me të drejtat për pjesëmarrje në hulumtim?

Ky hulumtim është realizuar nga Ambasada e Fëmijëve Megjashi. Nëse nuk jeni të kënaqur me hulumtimin ose fëmija juaj nuk ndihet rehat, ju lutemi kontaktoni Ambasadën e Fëmijëve Megjashi. Për pyetje në lidhje me të drejtat tuaja dhe të drejtat e fëmijës suaj si pjesëmarrës në hulumtim ose për të diskutuar probleme, shqetësime ose sugjerime lidhur me hulumtimin ose për të marrë informacion dhe/ose për të ofruar informacione për hulumtimin, ju lutemi kontaktoni Jordanka Ch. Trajkoska, në: 076 42 12 32 ose shkruaj një mesazh tek freelegalservice@childrensembassy.org.mk.



PËLQIMI NGA PRINDI/KUJDESTARI PËR PJESËMARRJE NË HULUMTIM

* Ju lutemi konfirmoni që i kuptoni informacionet e mësipërme.

Konfirmoj që i kuptoj informacionet e mësipërme në lidhje me hulumtimin.

Nëse ndonjë nga informacionet e mësipërme nuk është i qartë, ju lutemi kontaktoni intervistuesin që Ju jep këtë pëlqim.

* A pajtoheni që fëmija juaj të marrë pjesë në hulumtim dhe se përgjigjet e tij/saj duhet të përfshihen në raporte dhe materiale informative në lidhje me raportet, si pjesë e njohurive të përgjithshme?

Po, pajtohem.

Jo, nuk pajtohem.


* Në fund, duhet të shënoni

Emrin dhe
mbiemrin tuaj

Emrin e fëmijës
suaj

Data

ANEKS 2: Pyetësor mbi të drejtat e fëmijëve



PYETËSOR ANKETËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

PYETËSOR ANKETËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

Kush jemi ne?

Organizata jonë quhet Ambasada e Parë për Fëmijë në Botë Megjashi, ose shkurt Megjashi. Puna jonë e përditshme është të përmirësojmë të drejtat e fëmijëve në Maqedoni dhe në botë. Mund të gjeni më shumë informata mbi ne [këtu](#).

Pse përgatitet ky pyetësor?

Këtë pyetësor e përpiluar për të mësuar më shumë rreth të drejtave të fëmijëve, problemeve me të cilat përballen fëmijët dhe gjërat që ata mendojnë se duhet të përmirësohen. Kur themi fëmijë, nënkuptojmë të gjithë personat nën 18 vjeç.

Përgjigjet e këtij pyetësori do të na ndihmojnë të shkruajmë një raport që do të tregojë pamjen e vërtetë të situatës me të drejtat e fëmijëve. Ne do të bëjmë çmos që raporti të jetë në dispozicion të sa më shumë njerëzve dhe vendimmarrësve për t'i njohur ata me problemet dhe t'i motivojmë ata të bëjnë ndryshime.

Gjithashtu, përgjigjet tuaja të ndershme për çdo pyetje do të na ndihmojnë shumë në planifikimin e aktiviteteve të ardhshme të Megjashi që do të çojnë në kushte më të mira dhe respektim të drejtave të juaja dhe bashkëmoshatarëve tuaj.

Si mund të kontribuosh?

Për ne është e rëndësishme të dëgjojmë mendimin e sa më shumë fëmijëve. Sidoqoftë, pjesëmarrja në këtë pyetësor është vullnetar, që do të thotë që ju duhet të merrni pjesë vetëm nëse dëshironi. Pyetësori është gjithashtu anonim, që do të thotë se nuk keni nevojë të shkruani emrin dhe mbiemrin tuaj, dhe ne nuk do ta dimë se si secili prej juve ju është përgjigjur pyetjeve. Do të duhen rreth 45 minuta për të plotësuar pyetësorin. Nuk ka përgjigje të drejta ose të gabuara, por vetëm përgjigje të shkruara nga zemra, të sinqerta.

Si duket pyetësori?

Pyetësori u përpilua nga një grup të të rriturve nga Megjashi dhe nxënës të shkollave fillore dhe të mesme nga disa qytete në Maqedoni (një pjesë e pyetjeve janë ndryshuar sipas propozimeve të tyre kur një pjesë janë përpiluar nga vet fëmijët). Ai përbëhet prej 67 pyetjeve që ndahen në shtatë pjesë sipas temës dhe secila pjesë ka një titull që lidhet me temën dhe një pyetje shtesë në fund të pyetësorit. Shumica e pyetjeve vetëm më kanë përgjigje dhe do t'ju kërkohet të zgjidhni një ose më shumë opsione. Por ka edhe pyetje për të cilat duhet të shkruani mendimin tuaj. Këto përgjigje

janë shumë të rëndësishme për ne dhe ju lusim të jeni të sinqertë. Vetëm ashtu do t'i marrim informatat e nevojshme mbi atë që është e rëndësishme për ju dhe fëmijët tjerë.

Ky pyetësor përmban pyetje që kanë të bëjnë me shumë fusha të jetës së fëmijëve. Nëse donë të flasësh me të rritur për diçka që e ke të rëndësishme, mund të telefonosh në SOS telefonin për fëmijë dhe të rinj të Megjashi. Nëse donë të kuptosh më shumë mbi SOS telefonin mund të shoshën videon e shkurtë këtu.

E RËNDËSISHME!

Para se të mund të plotësosh pyetësin, duhet të marrim pëlqim nga prindi ose kujdestari yt. Pëlqimi që duhet të jepet nga prindi/kujdestari mund të gjendet [këtu](#).

* Të lusim të konfirmosh që një prej prindërve/kujdestarëve ka dhënë pëlqimin për të marrë pjesë në hulumtimin.

Vërtetoj se njëri prej prindërve/kujdestarëve të mi ka dhënë pëlqim për të marr pjesë në hulumtim.

PYETËSOR ANKETËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

INFORMATA TË PËRGJITHSHME

* Gjinia

- a) mashkullore
- b) Femërore
- c) Nuk dua të përgjigjem

* Sa vjet i ke?

* Cila është përkatësia jote etnike?

- Maqedonas/Maqedonase
- Shqiptar/Shqiptare
- Serb/Serbe
- Turk/Turke
- Rom/Rome
- Vllah/Vllahe
- Përkatësi tjetër etnike (shëno).

* Shkolla

- a) fillore
- b) e mesme

* Komuna

* Ku jeton?

- a) Qytet
- b) Fshat

A ka diçka tjetër që dëshiron të na tregosh për veten?

PYETËSOR ANKETËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

I NJOHURI ME TË DREJTAT E FËMIJËVE

* 1. A je i/e njohur me të drejtat e fëmijëve?

- a) Po
- b) Jo
- c) Pjesërisht

2. Thekso disa të drejta të fëmijëve të cilat të kujtohen. Nuk ka problem edhe nëse nuk të kujtohet asnjë për momentin, dhe mund të lësh atë pyetje të zbrazët.

1	<input type="text"/>
2	<input type="text"/>
3	<input type="text"/>
4	<input type="text"/>
5	<input type="text"/>
6	<input type="text"/>

* 3. Kur politikanët dhe gjykatat vendosin mbi pyetje që anë të bëjnë me fëmijët, ato duhet tu pyesin fëmijët për mendimin e tyre.

- a) Pajtohem.
- b) Nuk pajtohem.
- c) Nuk e di.

* 4. Gjithë të drejtat janë njëloj të rëndësishme, por për ty cila e drejtë është më e rëndësishme dhe pse?

* 5. Prej ku i ke marr informatat për të drejtat e fëmijës? (mund të rrethosh më shumë përgjigje)

- a) Shkollë
- b) TV
- c) Shtëpi
- ç) Internet
- d) Gazetë/revistë
- dh) Faresini/miq
- e) Organizata joqeveritare
- ë) Radio
- f) Tjetër (shëno)

* 6. A mendon se fëmijët duhet më shumë të edukohen mbi të drejtat e fëmijëve?

- a) Po, duhet të dinë më shumë.
- b) Jo, kanë mjaftë njohuri për to.
- c) Jo, nuk janë të interesuar që të mësojnë për të drejtat e fëmijëve.

* 7. A mendon se të rriturit duhet më shumë të edukohen mbi të drejtat e fëmijëve?

- a) Po, duhet të dinë më shumë.
- b) Jo, kanë mjaftë njohuri për to.
- c) Jo, nuk janë të interesuar që të mësojnë për të drejtat e fëmijëve.

* 8. A ke njohuri mbi Konventën e të Drejtave të Fëmijës?

- a) Po, kam dëgjuar për të.
- b) Po, kam dëgjuar për të dhe e kam lexuar.
- c) Jo.

* 9. A mendon se njerëzit rreth teje i respektojnë të drejtat e fëmijës?

	Po, tërësisht i respektojnë të gjitha të drejta, gjithmonë	Pjesërisht i respektojnë (disa të drejta respektohen, disa jo)	Aspak nuk i respektojnë
Në shtëpi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Në shkollë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Në vendbanimin tënd	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

10. A ke njohuri për raste kur nuk respektohen të drejtat e fëmijëve? Shpjego rastin.

11. Çfarë mendon, ku mund të drejtohen fëmijët nëse shkelen të drejtat e tyre? (shëno)

* 12. Në tabelën në vijim kemi disa pyetje. Të lutem përgjigju secilës në veçanti, me një prej përgjigjeve të ofruara (po, jo, nuk e di)

Nëse të shkelet ndonjë e drejtë, a do t'i ishe drejtuar:

	PO	JO	NUK E DI
arsimtarit/profesorit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
pedagogut, psikologut ose ndonjë profesionisti tjetër në shkollën tënde?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
familjes tënde?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
shokut/shoqes?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
ndonjë SOS linjeje?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
qendrës për Punë Sociale?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
policisë?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
organizate joqeveritare?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
spitalit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Avokatit të Popullit?	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

* 13. A ke kërkuar ndihmë kur të është shkelur ndonjë e drejtë?

- a) Deri tani asnjë e drejtë nuk më është shkelur.
- b) Jo, nuk u drejtova askund.
- c) Nuk e dija ku të drejtohem.
- ç) Po, kërkoja ndihmë prej (shëno prej ku ke kërkuar ndihmë).

14. Nëse u përgjigje me "Po", sa të ndihmoi personi që iu drejtove?

- a) Shumë më ndihmoi
- b) Deri diku më ndihmoi
- c) Aspak nuk më ndihmoi

* 15. A ke dëgjuar për Ambasadën e Parë për Fëmijë në Botë Megjashi?

- a) po
- b) jo

16. Çili mendon se është roli i Ambasadës së Parë për Fëmijë në Botë Megjashi?

* 17. A ke dëgjuar ndonjëherë për Avokatin e Popullit?

- a) Po
 b) Jo

18. Sipas teje, cili është roli i Avokatit të Popullit në mbrojtjes e të drejtave të fëmijës?

* 19. A je i/e përfshirë në aktivitete me të cilat mund t'ju ndihmohet fëmijëve të drejtat e të cilëve nuk respektohen?

- a) Po
 b) Jo

Nëse po, cilat janë ato aktivitete?

* 20. A mendon se fëmijët kanë fuqinë që t'i ndryshojnë sendet që i vlerësojnë si të rëndësishme?

- a) Po
 b) Disa gjëra mund të ndryshohen, disa jo
 c) Jo, asgjë nuk mund të ndryshohet

Pse mendon ashtu? (Shpjego).

PYETËSOR ANKETËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

II MJEDISI SHKOLLOR

* 21. Подолу се неколку реченици поврзани со училиштето. За секоја од речениците означи колку се согласуваш.

	Pajtohem	Pjesërisht pajtohem	Nuk pajtohem
Kënaqem kur jam në shkollë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ndjehem sigurt në shkollë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Nëse nuk ndjehem sigurt mund të kërkoj ndihmë nga arsimtar/profesor ose tjetër të rritur	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Arsimtarët/ profesorët dhe të punësuarit e tjerë në shkollë më respektojnë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Kujdestari i klasës i dërgon nxënësit tek psikologu ose pedagogu vetëm nëse kanë bërë ndonjë problem	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Nxënësit tjerë nga shkolla ime më respektojnë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Arsimtarët/profesorët e mi e respektojnë mendimin tim	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Unë jam i/e përfshirë kur merren vendime në shkollën time	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ndjehem se i takoj shkollës time	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Arsimtarët/profesorët na motivojnë të mësojmë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Arsimtarët/profesorët gjatë secilës orë duan të sigurohen se e kemi kuptuar materialin	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

	Pajtohem	Pjesërisht pajtohem	Nuk pajtohem
Materiali që mësojmë në orë është zakonisht interesant	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ajo që mësoj në shkollë është e dobishme dhe do t'më ndihmon në të ardhmen	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Kur kam ndonjë dilemë ose problem flas me psikologun, pedagogun ose profesionistët tjerë në shkollë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Në shkollën time ka hapësirë mirë të pajisur për aktivitete sportive	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Në shkollën time kemi ujë të pijshëm	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Tualetet në shkollën time janë të pastra, ka mjete për higjienë, si p.sh. sapun, letër tualeti dhe rregullisht mirëmbahet pastërtia.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Tualetet në shkollën time nuk janë të pastra andaj i shmangem tualetit derisa jam në shkollë.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Në shkollën time i përkushtohet vëmendje të mjaftueshme higjienës (rregullisht pastrohen gjitha hapësirat).	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
* 22. E dua shkollën time pasi ... (të lutem përfundo fjalinë)			
<input type="text"/>			
* 23. Po të isha unë drejtor/drejtoreshë në shkollën time unë do kisha (të lutem përfundo fjalinë)			
<input type="text"/>			
* 24. Çfarë mendon se duhet të ndryshohet në shkollën tënde?			
<input type="text"/>			

* 25. Si sillen pjesa më e madhe e nxënësve dhe të rriturve në shkollën tënde ndaj:

	Ndaj tyre sillen më mirë	Ndaj tyre sillen më keq	Ndaj tyre sillen sik	Nuk e di
Fëmijë me nevoja të posaçme	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Fëmijë të bashkësisë tjetër etnike	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Fëmijë të prindërve të divorcuar	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Fëmijë pa prindër	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Fëmijë të familjeve financiarisht të varfra	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Fëmijë të familjeve financiarit të pasura	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Fëmijë prej qyteteve tjera	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Fëmijë prej fshati	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Fëmijë që janë të detyruar të punojnë nga të rriturit (në fushë, të shesin në treg, të lypin lëmoshë në rrugë, etj.) andaj mundojnë nga orët	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

* 26. A ka në shkollën tënde: (rretho gjitha përgjigjet që vlejnë për shkollën tënde)

- a) pajisje për nxënës/nxënëse që nuk shohin mirë (libra, kompjuterë dhe/ose teknologji tjetër me alfabetin Braj ose shkrimi i posaçëm Braj, i paraparë për persona me të shikuarit e dëmtuar) ose që nuk dëgjojnë mirë.
- b) pajisje për ndihmë për nxënës/nxënëse që nuk dëgjojnë mirë
- c) person/asistent që do t'ju ndihmon fëmijëve në mësim gjatë orëve
- ç) në vendet ku ka shkallë, ka edhe rampë nëpër të cilën nxënësi/nxënësjë që lëviz me karrocë mund të hip ose të zbrit
- d) hapësira të posaçme me sende të ndryshme, drita të ndryshme, muzikë dhe ngjashëm, ku mund të shkojnë nxënësit/nxënëset që të ndjehen më mirë
- dh) nuk ka asgjë nga të përmendurat.

* 27. A ju ndihmojnë arsimtarët dhe asistentët në shkollën tënde nxënësve/nxënëseve me pengesa?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

PYETËSOR ANKETËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

III KOHA E LIRË

* 28. A ke mjaft kohë të lirë për t'i kryer aktivitetet që të pëlqejnë?

- a) Po, gjithmonë kam kohë për aktivitetet që i pëlqej
- b) Jo, asnjëherë
- c) Ndonjëherë, kur më lejojnë obligimet tjera

* 29. Kohën e lirë e kam të kufizuar pasi që (mund të rrethosh më shumë përgjigje):

- a) kam tepër shumë detyra shtëpie dhe obligime tjera shkollore
- b) vizitoj shumë aktivitete jashtë shkollës (p.sh. kurse, klube sportive)
- c) Kam tepër shumë obligime (p.sh. kujdesem për anëtar të familjes, ndihmoj me punët e shtëpisë ose punoj jashtë shtëpisë)
- ç) Tjetër (shëno).

* 30. A ke kushte për të kryer aktivitetet që i pëlqen në vendbanimin tënd?

- a) Po
- b) Jo

31. Ajo që mungon në vendbanimin tim është (plotëso).

* 32. Në tabelën më poshtë shëno se sa shpesh ke kryer zakonisht ndonjë nga aktivitetet vijuese.

	Shpesh	Ndonjëherë	Rrallë	Asnjëherë
Shoqërim me shokë/shoqe në shtëpi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Shoqërim me shokë/shoqe jashtë shtëpie	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Shikim TV	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ecje	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Lexim për kënaqësi	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Dëgjim i muzikës	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Vizitë e ngjarjeve kulturore dhe artistike (p.sh. shfaqje teatrale, galeri, muze)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Pjesëmarrje në aktivitete sportive (p.sh. futboll, basket, hendboll, not)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Mbledhje familjare ose piknikë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Dalje në kafene ose diskoteka	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Kinema	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Vozitje e biçikletës/skejt	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Vizitë e garave sportive	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Surfim në internet	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Kaloj kohë në rrejtët sociale (p.sh. Facebook, Snapchat, Tik Tok ose Instagram)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Orë private për këndim/instrumente	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Orë private për gjuhë të huaja	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Shëtitë kafshën e shtëpisë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

33. Aktivitete tjera që i bëj shpesh janë (shëno):

34. Aktivitete tjera që i bëj ndonjëherë janë (shëno):

35. Aktivitete tjera që i bëj rrallë janë (shëno):

* 36. A ka në vendbanimin tënd mjaftë mundësi për sportim?

- a) Po, ka mjaftë klube sportive dhe aktivitete.
- b) Jo, nuk ka.
- c) Nuk e di.

* 37. Çfarë, sipas mendimit tënd, i kufizon fëmijët që të merren me sport? (shëno gjitha përgjigjet që mendon se janë të vlefshme)

- a) Nuk kanë kohë
- b) Shpenzimet e larta
- c) Nuk ka transport
- ç) Kanë frikë se nuk do jenë të suksesshëm në sport
- d) Qasja e pakëndshme e trajnerëve ndaj fëmijëve
- dh) Nuk kanë shoqëri për të ndjekur sportin
- e) Vajzave ju vjen turp të marrin pjesë në sporte "të djemve"
- ë) Tjetër (shëno)

* 38. Çfarë mendon se si motivon fëmijët që të marrin pjesë në aktivitete sportive? (shëno)

PYETËSOR ANKETËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

IV SHËNDET DHE CILËSI E JETËS

* 39. A mendon se ke jetë të shëndetshme? (përgjigju secilës fjali, duke e shënuar se sa shpesh e bënë)

	Shpesh (gati se çdo ditë)	Rrallë (1-2 herë në javë)	Asnjëherë
Konsumon sasi të mjaftueshme të ushqimit të shëndetshëm, si pemë dhe perime	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Fle mjaftueshëm	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Je mjaft aktiv/e fizikisht (p.sh. ec, nget biçikletën, sporton)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

* 40. Kur je në shkollë, çfarë hanë gjatë pushimit të madh? (rretho gjitha përgjigjet që vlejné për ty)

	Çdo ditë	1-2 herë në javë	Asnjëherë
Ushqim të përgatitur prej shtëpie	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ushqim të siguruar nëpërmjet shkollës	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ushqim që blej nga dyqani i afërt ose furra/lokal për sandviçë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Nuk ha asgjë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

* 41. Çfarë lloj ushqimi hanë gjatë pushimit të madh në shkollë (shëno të gjitha përgjigjet që vlejné për ty):

	Çdo ditë	Dy ose tre herë në javë	Asnjëherë
Fruta	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Perime	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ushqim të lehtë (shkopinj me krip, smoki, çips, etj.)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ushqim të shpejtë (sandviç të ftohtë, tost, hamburger, pica, etj.)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Produkte furre (gjevrek, byrek/koll byrek, kifje, etj.)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Diçka ëmbël (çokollatë, biskotë ose keks, etj.)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Nuk ha asgjë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

* 42. Në shkollë prej 1 deri 5 si do kishe vlerësuar kënaqësinë tënde nga ushqimi që e merr/blen derisa je në shkollë?

	1	2	3	4	5
Sasia	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Llojllojshmëria e ushqimit	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Cilësia e ushqimit (a është e freskët, e shijshme, e shëndetshme)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

* 43. Në tabelë ka fjali që shprehin se si ndjehesh në tre muajt e fundit dhe duhet për çdo fjali të zgjedhësh se sa shpesh ndjehesh ashtu:

	Gati se çdo ditë	Prej kohe në kohë	Asnjëherë
Ndjehem optimist/e kur mendoj për ardhmërinë	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ndjehem i/e dobishëm/me	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Kam vetëbesim, ndjehem i/e sigurt në vete	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ndjehem i/e dashur	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ndjehem i/e disponuar	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ndjehem nën stres (shqetësuar)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ndjehem i/e pikëlluar	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ndjehem i/e padisponuar	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

* 44. A ndjehesh i/e lirë të flasësh për ndjenjat e tua (veçanërisht kur ndjehesh i/e pikëlluar ose shqetësuar)?

- a) Nuk dua të flas me askënd se si ndjehem
- b) Nuk kam më kë të flas
- c) Nuk kam më kë të flas, por i shënoj ndjenjat e mia në ditar, tregim ose këngë
- ç) Po, flas me (plotëso).

* 45. Nëse je i/e shqetësuar në shkollë, a di ndonjë të rritur në shkollë me të cilin/ën mund të flasësh? (Shëno).

* 46. A di ose njih ndonjë fëmijë që nuk ka pranuar ndihmë mjekësore kur atij/asaj i është dashur? (Përshkruaj).

* 47. A njih ose ke dëgjuar për fëmijë që i mungon shtëpi e ngrohtë, ushqim, ujë, tesha të pastra, mjete higjienike, ose çfarëdo sendi tjetër që mund ti nevojitet për jetë të mirë. Përshkruaj çfarë saktë i mungon dhe a i ka ndihmuar dikush?

PYETËSOR ANKETËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

V MJEDISI JETËSOR

* 48. A ka në afërsi të vendbanimit tënd hapësira të pastra dhe të sigurta publike, si për shembull parqe?

- a) Po, ka
- b) Ka, por nuk janë të pastra dhe të sigurta
- c) Nuk ka

* 49. A keni problem me ajrin e ndotur në vendbanimin tënd, veçanërisht gjatë dimrit?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

* 50. Si ndjehesh ti kur ajri është i ndotur dhe si të ndikon ajo në jetën e përditshme? (Përshkruaj).

* 51. A ka vendbanimi yt probleme tjera ekologjike? (shëno)

* 52. A ke marr pjesë në ndonjë aktivitet ekologjik?

- a) Jo
- b) Jo, pasi nuk ka në afërsi, por po të kishte do isha bashkëngjitur.
- c) Po, në (shpjego çfarë aktiviteti).

* 53. Çfarë masash dhe sa shpesh i ndërmer shkolla jote për mbrojtje dhe ruajtje të mjedisit jetësor?
(rretho gjitha përgjigjet që vlejnë për shkollën tënde)

	Po, dy ose më shumë herë në vit	Po, njëherë në vit	Jo
Organizon aksione për pastrim të oborrit të shkollës	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Organizon zbulim të oborrit të shkollës me mbjellje të drunjtëve dhe luleve	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ka seksion ekologjik nëpërmjet cilit organizojmë aksione të ndryshme në vendbanimin tim	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Organizon aksione për mbledhje të plastikës	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Organizon aksione për mbledhje të baterive të përdorura dhe pajisjeve elektrike të përdorura	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Organizon ligjërata publike të ekspertëve të jashtëm për nxënësit	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

PYETËSOR ANKETËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

VI SIGURIA

* 54. Në shkallë prej 1 deri 5, ku 1 shënon më pak sigurt, kurse 5 shumë sigurt, shëno se sa i/e sigurt ndjehesh:

Në shtëpi

Shkollë

Në lagje

Në internet

* 55. Çfarë bën të ndjesh i/e sigurt në vendbanimin tënd? Shëno.

* 56. Çfarë bën të ndjesh i/e pasigurt në vendbanimin tënd? (mund të rrethosh më shumë përgjigje)

- a) Prania e dhunës
- b) Fqinjë të pakëndshëm
- c) Tepër shumë vetura
- ç) Qenë endacak
- d) Mungesë e ndriçimit rrugor
- dh) Tjetër (shëno)

* 57. A ke qenë ndonjëherë viktimë e dhunës?

- a) Jo
- b) Po

Nëse mundesh, shpjego kush e ka kryer, ku (në shtëpi, në rrugë, në shkollë, etj.) ka ndodhur dhuna, çfarë lloji dhune ka qenë (fizike, në internet, ofendime, thashetheme, shkycje nga grupi, etj.) dhe si ke vepruar ti.

* 58. A njeh dikë që ka qenë viktimë e dhunës?

- a) Jo
 b) Po

Nëse mundesh, shpjego kush e ka kryer, ku (në shtëpi, në rrugë, në shkollë, etj.) ka ndodhur dhuna, çfarë lloji dhune ka qenë (fizike, në internet, ofendime, thashetheme, shkycje nga grupi, etj.) dhe si ke vepruar ti.

* 59. A i ke ndihmuar dikujt që ka qenë viktimë e dhunës?

- a) Po
 b) Jo

* 60. A ke qenë ti, për ndonjë shkak, në situatë të lëndosh dikë?

- a) Po
 b) Jo

Nëse mundesh, shpjego.

* 61. Në çfarë mënyre mendon se është më lehtë t'i kundërshtosh dikujt dhe të shpëtosh në qoftë se dikush mundohet të jetë i dhunshëm ndaj teje?

* 62. A janë shpërndarë ndonjë herë, pa pëlqimin tënd, fotografia ose videoja jote në Internet?

- A) Po
 B) Jo
 C) Nuk më ka ndodhur personalisht, por njoh bashkëmoshatar/e që i ka ndodh kjo

* 63. Ku do të drejtohesh nëse dikush të keqtrajton në Internet ose keqpërdor të dhëna/fotografi/video të tua? (mund të rrethosh më shumë përgjigje)

- a) Në familje
- b) Në shkollë
- c) Shok/shoqe
- ç) Në polici
- d) Në organizatë joqeveritare
- dh) Në Drejtorinë për Mbrojtje të të Dhënave Personale
- e) Tjetër (shëno).

* 63. Ku do të drejtohesh nëse dikush të keqtrajton në Internet ose keqpërdor të dhëna/fotografi/video të tua? (mund të rrethosh më shumë përgjigje)

- a) Në familje
- b) Në shkollë
- c) Shok/shoqe
- ç) Në polici
- d) Në organizatë joqeveritare
- dh) Në Drejtorinë për Mbrojtje të të Dhënave Personale
- e) Tjetër (shëno).

PYETËSOR ANKETËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

VII DISKRIMINIMI

* 64. A je ndjerë pakëndshëm në ndonjë situatë pasi që dikush është nuk është sjellë me ty sikur ndaj të tjerëve?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk mund të vlerësoj

65. Nëse përgjigja në pyetjen e mëparshme ka qenë Po, cili ka qenë shkaku që je ndjerë ashtu, në fakt i/e diskriminuar? (mund të rrethosh më shumë përgjigje)

- a) Moshë
- b) Gjuha
- c) Përkatësia etnike
- ç) Gjinia
- d) Përkatësia fetare
- dh) gjendja financiare e familjes
- e) pengesat
- ë) tjetër

Nëse mundesh, përshkruaje situatën.

* 66. A ke dëshmuar diskriminim?

- a) Po
- b) Jo

Nëse përgjigja është "Po", si ke reaguar?

* 67. A ke diskriminuar dikë ti?

a) Po


b) Jo

Nëse mundesh, shpjego.

PYETËSOR ANKETËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

INFORMATA SHITESË


68. A donë të shtosh diçka që ndoshta kemi harruar të pyesim?



PYETËSOR ANKETËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

TË FALEMINDERIT SHUMË PËR PËRGJIGJET E TUA!

Nëse do të flasësh për çfarëdo çështje, mund të telefonosh në SOS linjën për fëmijë dhe të rinjtë të Megjashi-t në 02 2465 316 ose 070 390 632



Ambasada e Parë për Fëmijë në Botë Megjashi –
Republika e Maqedonisë
rr. "Kosta Novakoviç" nr. 22a, 1000 Shkup
tel. +389 2 2465 316
e-mail: info@childrensembassy.org.mk
Ueb faqja: www.childrensembassy.org.mk

